


VENDIMI I POSAÇEM PER KOMITETIN E ARTIT DHE KULTURES

DOKUMENTET E SIGURIMIT, JA LISTA E 28 ARTISTEVE QE U VUNE NE MBIKEQYRJE

Vendimet e dhëna për largimet nga puna dhe për burgosjen e emrave që u konsideruan të rrezikshëm ▶ F16-17



[SHQIPTARJA.COM]

ÇMIMI 30 LEKË | VITI V - NR. 263 | EPREME, 06-11-2015 | www.shqiptarja.com

PERPLASJA

BEN BLUSHI PUSHKATOI PER HERE TE DYTE LEF NOSIN

Ina Kosturi zbardh korrespondencën mes Lef Nosit dhe Qemal Stafës para themelimit të Partisë Komuniste

▶ F 22

DOSJA E SHIK



FATOS KLOSI: BERISHA MBROJTI SIGURIMSAT QE VRANE REMZI HOXHEN

Debati në parlament, Sali Berisha flet për akuzën mbi takimin me Milosheviçin dhe bisedën Arkan-Gazidede

▶ F 4-5



PLANI PER TE MOS RRITUR TAKSAT

SHKRIHEN AGJENCITE, SHKURTOHEN PUNONJESIT

Urdhri për Ministrat: Të rishikohet dhe struktura e punonjësve. Institucionet që kanë objekt të përafërt pune priten të shkrihen në një të vetme. Ja kush janë 100 agjencitë që do të kalojnë në sitën e shkurtimeve

▶ FAQE 2-3

VIOLA SPIRO: NDIHEM E PLOTESUAR, KAM GJETUR MASHKULLIN E ZEMRES

Prezantuesja flet për botën e spektaklit dhe jetën personale. Rrëfimi për largimin nga "Fiksi" dhe kalimi te "Dance With Me" ▶ F 21



NDRYSHIMET KRYETARET E BASHKIVE JO ME SHUME SE 3 MANDATE

Pushteti vendor merr 41 kompetenca. Këshilltarët pa rrogë ▶ F 7

NE GJYKATE FRROKU: TE SHKOJ NE KUVEND SI DEPUTETET E "AGIMIT TE ARTE"

I ndërprerit rroga nga Kuvendi, akuzohet për vrasje në Belgjikë ▶ F 14

Afati

Buxheti në Kuvend brenda nëntorit



Legislacioni përcakton që drafti i buxhetit për vitin pasardhës duhet të paraqitet në Kuvend përpara gjysmës së nëntorit. Në vitin e parë të marrjes së pushtetit, Qeveria nuk arriti ta respektojte këtë afat, duke e paraqitur rreth mesit të nëntorit. Opozita akuzoi se vonesa u bë qëllimisht nga ana e qeverisë

socialiste, për t'i fshehur publikut taksat e tatimet e reja, ashtu si dhe për të lënë në hije shpenzimet sipas dikastereve. Për këtë vit, Ministria e Financave ka bërë me dije se projekti është në fazë përpunimi, bashkë me paketën fiskale, e cila u është shpërndarë për konsumit palëve të interesit.

Nisin shkurtime të Agjencitë, gati struktura e re

Me buxhetin e ri do të ulen shpenzimet për paga e honorare, nuk do të rriten taksat

MATEOS BOSTANI
TIRANE

Viti 2016 do të nisë me një rishikim të organizimit Agjencive të varësive së ministrive. Ristrukturimi do të nisë me suprimimin e një pjese të mirë të Agjencive dhe Drejtorive që janë në varësi të ministrive. Vendimi për këtë nisim ka ardhur pas kërkesave të Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili ka kërkuar rritjen e taksave, në mënyrë që të rriten të ardhurat në Buxhetin e Shtetit. Propozim që është kundërshtuar prej kryeministrit Rama. Për të krijuar një stabilitet më të fortë mes të ardhurave dhe shpenzimeve, duket se është gjetur një tjetër zgjidhje, ajo e shkurtimeve të shpenzimeve. Një nga pikat që po diskutohet për këtë është shkrija e strukturave që nuk janë në efikasensë të plotë. Burimet kanë bërë të ditur se kryeministri Edi Rama u ka kërkuar ministrave të paraqesin propozimin për formën e re të organizimit të këtyre institucioneve, për të shkruar drejt uljes së numrit të punonjësve si dhe të shpenzimeve të tyre. Në listën e gjatë të agjencive, që nuk janë pjesë të organigramës së ministrive, vihen re struktura që nuk kanë asnjë efektshmëri, apo që kanë mbivendosje të kompetencave, ndaj dhe në prezantimin e buxhetit të ri, pritet që të parashikohet ulja e shpenzimeve përsa u përket pagave dhe honorarëve.

PROPOZIMI

Burimet kanë bërë të ditur se ekspertët e ministrive janë duke punuar për bashkimin e agjencive që kanë mision të përafërt si pasojë dhe shkur-

timin e personelit. Ky ristrukturim do të prekë të gjitha agjencitë, ndërkohë që do të shoqërohet dhe me një përkrahim të ri të misionit dhe të prishmërisë që do të ketë. Megjithatë pritet që dhe agjencitë e rëndësishme të preken

nga reforma, kjo duke rishikuar dhe një herë efikasitetin në punë të stafit të tyre si dhe të ngarkesës që ata kanë pasur përgjatë vitit 2015. Burimet kanë bërë të ditur se në çdo ministri ka nisur puna për të bërë propozimet përkatëse për

riorganizimin e tyre, por që gjithsesi, parashikohet një ulje e numrit të punonjësve apo dhe një rishikim i pagave që do të kenë. Shkarkimet pritet të mos prekin vetëm specialistët e agjencive, por dhe të drejtuesve.

PROPOZIMET

Burimet kanë bërë të ditur se propozimet për strukturën e re janë diskutuar me grupin e punës që ka nisur hartimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2016, ndërkohë që për to do të

hartohet dhe një relacion me argumentimin përkatës. Në vitin e ardhshëm pritet që në varësinë e ministrive të mos jenë më 100 Agjenci, Institute dhe Drejtori të Varësive por një numër më i vogël dhe me staf të reduktuar.



100 AGJENSITË E VARESISË TË MINISTRIVË

- Agjencia e Trajtit të Koncesioneve
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
- Agjencia Kombëtare e Turizmit
- Agjencia Kombëtare e Bregdetit
- Agjencia Kombëtare e Duhanëve
- Agjencia për Zhvillimin Bujqësor e Rural
- Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
- Agjencia e Auditimit të Fondeve të BE
- Agjencia e Akreditimit
- Agjencia Kombëtare e Protimeve të Vlerësimit
- Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional
- Agjencia e Shërbimeve të Sportit
- Agjencia e Shërbimit Arkeologjik
- Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës
- Agjencia e Falimentit
- Agjencia e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve
- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
- Agjencia Kombëtare e arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
- Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
- Agjencia Telegrafike Shqiptare
- Agjencia e Prokurimit Publik
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
- Agjencia Kombëtare e Sigurisë Kompjuterike
- Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale

- Agjencia Kombëtare Bërthamore
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
- Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit
- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
- ALUIZNI
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
- Autoriteti Rrugor Shqiptar
- Autoriteti i Aviacionit Civil
- Autoriteti i Konkurrencës
- Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
- Autoriteti Kombëtar i Çertifikimit Elektronik
- Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor
- Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve
- Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave
- Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës
- Drejtoria e Përgjithshme Detare
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Drejtoria e Shërbimeve dhe Doganave
- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
- Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
- Drejtoria e Mbrojtjes së Shërbimit të Provës
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
- Drejtoria e Përqasjes Juridike Ndërkombëtare

- Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin
- Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
- Drejtoria e Përgjithshme e Radiotelevizionit Shqiptar
- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit
- Drejtoria Qendrore e Rezervave
- Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
- Drejtoria e Informacionit të Kualifikuar
- Drejtoria e Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Mjeteve të Transportit
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
- Drejtoria e Koordinimit të Projekteve dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
- Zyra për të Drejtën e Autorit
- Enti Shtetëror i Farave dhe Fidaneve
- Bursa e Tiranës
- Drejtoria e Akreditimit
- Drejtoria e Patentave dhe Markave
- Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
- Drejtoria e Metrologjisë dhe Kalibrimit
- Drejtoria e Bujqësisë
- Departamenti i Administratës Publike
- Shkolla e Administratës Publike
- Sekretariati i Ujit
- Inspektoriati Qendror
- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve
- Njësia e Mbrojtjes së Lojrave të Fatit
- Qendra e Publikimeve Zyrtare

Propozimet Rishikohet dhe organigrama e ministrive



Në sitën e shkurtimeve nuk do të jenë vetëm agjencitë dhe institucionet në varësi të ministrive, por dhe vetë organigrama e ministrive. Burimet kanë bërë të ditur se të gjithë ministrive u është kërkuar rishikimi i organigramës si dhe studimi i mundësisë së shkurtimit të vendeve të punës. Po ashtu, mësohet se është kërkuar që riorganizimi i ministrive të mos prekë performancën dhe realizimin e shërbimeve të kërkuara, por kalimi drejt një strukture praktike dhe profesionale. Burimet kanë bërë të ditur se tashmë ministrinë kanë nisur punën dhe analizimin e situatës, për të arritur në propozime konkrete. Ky veprim do të pasqyrohet dhe në buxhetin e shtetit për vitin e ardhshëm, ndërsa pritet që në këtë buxhet të rriten shpenzimet për a të përkjet investimeve. Një tjetër pikë e rëndësishme që do të paraqitet në Kuvend do të jetë dhe paketa e re fiskale ku do të paraqiten dhe taksat që do të ulen apo do të rriten.

MATEOS BOSTANI
TIRANË

Në varësi të 19 ministrive të qeverisë, funksionojnë rreth 100 agjenci. Në listën e gjatë, të cilat paguhen nga buxheti i shtetit, vihen re dhe institucione që pak kush e ka informacionin për ekzistencën e tyre. Në strukturën e tyre ka agjenci që funksionojnë me një numër të kufizuar punonjësish, deri në 4 persona por dhe agjenci të rëndësishme të cilat në organikën e tyre kanë mbi 20 të punësuar. Sigurisht në strukturën e tyre, nuk mungojnë drejtuesit të cilët përfitojnë paga të larta, kjo dhe për shkak të strukturës së pagave në Shqipëri.

Burimet kanë bërë të ditur se një pjesë e madhe e këtyre agjencive kanë funksionuar si të tilla prej vitesh, ndërsa u kanë shpëtuar riorganizimit të ministrive. Pavarësisht të ndryshimit të emrave, agjencitë e pavarura kanë vijuar të marrin fonde nga buxheti i shtetit përgjatë viteve, por dhe me ndryshimin e qeverive, sërish këto agjenci kanë vijuar me marrjen e fondeve, pavarësisht programit të dhënë për rishikimin e këtyre strukturave.

Në të dhënat e publikuara prej Thesarit të Shtetit vëren se shpenzime ka jo vetëm prej agjencitë "hije", por dhe për ato institucioneve që kanë pushuar së ekzistuari. Rasti më i fundit është ai i Bursës së Tiranës, ku punonjësit, pavarësisht se Bursa u mbyll, vazhduan të merrnin pagën. Në fakt vendimi për mbylljen e Bursës së Tiranës u mor për shkak se ajo nuk funksionoi asnjëherë.

Por në listën prej 100 Agjencive janë dhe shumë të tjera që rrallë shfaqen për publikun, apo pak kush e di nëse ato funksionojnë apo jo, ndaj dhe pritet që të ketë një rishikim të plotë të strukturës së tyre për të arritur në një organigramë tërësisht funksionale dhe me më pak drejtues por me më shumë ekspertë. Burimet kanë bërë të ditur se pritet të ketë një shkrirje të institucioneve që kanë mision të përafërt, madje dhe duke ofruar lehtësi për individët apo bizneset, ku në një zyrë të vetme mund të merret shërbimi që ofrohet nga 2 ose më shumë agjenci të ndryshme. Por reforma nuk do të preka vetëm agjencitë që ofrojnë shërbime, por dhe ato agjenci që realizojnë studime. Në këtë rast do të synohet që agjencitë që kanë objektin e përafërt të studimit të kërkohet bashkimi i tyre në një. Kjo do të kërkojë dhe një rishikim të strukturës apo krierteve që do të kërkohet të plotësojë një punonjës. Burimet kanë bërë të ditur se më e rëndësishme do të jetë kërkesa që Agjencitë që do



Ministria e Financave

Shpenzimet

Mes Agjencive anonime ka dhe institucione të cilat vijojnë të marrin fonde, pavarësisht se rezultojnë të jenë të shkrira, por që punonjësit paguhen

Ja 100 agjencitë që "rrjepin" fonde në heshtje nga buxheti i shtetit

Kush janë organet në varësitë ministrive që rrezikohen nga strukturimi

të mbesin të jenë dhe më aktive dhe funksionale.

BUXHETET


Burimet kanë bërë të ditur se një ndër kërkesat e kryeministrit për rishikimin e agjencive të

varësisë ka qenë dhe shikimi i mundësisë që agjencitë të gjenë vetë të ardhurat të gjenerojnë vetë të ardhurat dhe mos të varen vetëm nga buxheti i shtetit. Sigurisht që të fondet do të alokohen nëpërmjet buxhetit, por do të duhet që agjencitë të

kontribuojnë në të ardhurat e buxhetit, si formë për realizimin e të ardhurave prej agjencive janë pasi nëpërmjet ofrimit të shërbimeve, por dhe nga krijimi i të ardhurave prej studimeve që këto Agjenci do të realizojnë.

KONTROLLI/ TË ARDHURAT E SHPENZIMET NËN MONITORIMIN E FMN

Buxheti 2016 kalon për diskutim në këshillin e ministrave



Buxheti
Buxheti i Shtetit tashmë është në fazën përfundimtare të përgatitjes, teksa qeveria është konsultuar dhe me ekspertët e FMN

Projektbuxheti i vitit 2016 ka mbërritur në Këshillin e Ministrave për diskutim. Sipas burimeve nga ministria e Financave, projektbuxheti po shqyrtohet në Këshillin e Ministrave, njëkohësisht edhe nga misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili mbërriti në vendin tonë më 28 tetor. Mësohet se grupi i punës në Këshillin e Ministrave ka zhvilluar një mbledhje jashtë radhe për të diskutuar p/buxhetin si dhe paketën e re fiskale. "Ekspertët e Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave, kanë hartuar projektbuxhetin e vitit 2016 bazuar në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, të rishikuar, për periudhën 2016 - 2018, miratuar në qeveri në fund të muajit korrik të këtij viti", thanë burimet. Sipas të dhënave të miratuara në Kuadrin Makroekonomik e Fiskal, për vitin 2016 planifikohet një rritje ekonomike prej 3.4 % të PBB-së. Të ardhurat parashikohen rreth 422, 984 milionë

lekë, ndërsa shpenzimet 464, 959 milionë lekë. Misioni i Fondit Monetar Ndërkombëtar i kryesuar nga shefja e misionit Anita Tuladhar nisi të mërkurën e javës që lamë pas takimet zyrtare me autoritetet më të larta të vendit tonë për të diskutuar mbi treguesit makroekonomik të vendit, projektbuxhetin e vitit 2016 si dhe paketën fiskale që shoqëron atë. Burime nga ministria e Financave bënë të ditur që Misioni i FMN-së vijon takimet me zyrtarë të lartë të ministrisë së Financave, asaj të Ekonomisë si dhe Bankës së Shqipërisë. Misioni i FMN-së do të jetë në Tiranë deri në datën 10 nëntor dhe sipas traditës do të mbyllë takimet duke dhënë konkluzionet përmes një konferencë të përbashkët për shtyp me ministrin Cani, ministrin e Ekonomisë, Ahmetaj, si dhe Guvernatorin. Në këtë konferencë pritet të bëhen të ditur dhe pritshmëritë për vitin 2016.

- Avokatura e Shtetit
- Instituti i Mjekësisë Ligjore
- Komisioni Shtetëror i Ndhimës Juridike
- Komiteti Shqiptar i Birësimeve
- Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkerkuesit
- Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike
- Garda e Republikës
- Organi Kombëtar i Investigimeve të Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil
- Instituti i Transportit
- Instituti i Zhvillimit të Arsimit
- Inspektoriati Shtetëror i Arsimit
- Shërbimi Social
- Shërbimi Kombëtar i Punësimit
- Inspektorati i Punës
- Instituti i Shëndetit Publik
- Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjaktit
- Qendra Kombëtare e Mirërritjes Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve
- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
- Qendra Kombëtare e Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
- Reparti i Inspektimit dhe Shpëtim Minierave
- Bordet e Kullimit (13)
- Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
- Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore

Braçe-Berishës: Trego ku janë eshtrat e Remzi Hoxhës

Berisha: "S'kam dijeni për ngjarjen. Fatos Klosi zhduku dosjen"

ESIONA KONOMI
TIRANE

Cështja "Remzi Hoxha" është rikthyer pas shumë kohësh në debatin parlamentar, kësaj rradhe me iniciativë të deputetit socialist Erjon Braçe. Ai i kërkoi ish kryeministrit Berisha që t'u tregojë familjarëve të Remzi Hoxhës se ku fshihen eshtrat e tij. Ai ju drejtua dhe ministrit të Brendshëm, duke i kërkuar që të sjellë Ilir Kumbaron në Shqipëri. "Një gjë nuk ja u fal që ju të na kërkoni të heshtim për ata krimet që kanë lidhje me funksionarët e shtetit të asaj periudhe. Ju Berisha dhe unë e njohim Remzi Hoxhën. Nuk e di në ç'rrethana e njihni ju, por unë e kam njohur si gazetar në "Zërin e Popullit." Ishte shqiptar i madh që ka luftuar për atdheun e tij. Jemi në ditët kur ai jo vetëm nuk është më sepse u torturua, u vra dhe ju zhdukën eshtrat por kur familjarët kërkojnë kockat e tij, për të patur një varr dhe për ta qarë atje mbi varr. Keni detyrimin si gjysh, si prind, si vëlla, t'i thoni asaj familje se ku janë eshtrat e Remzi Hoxhës. Të kërkoj vetëm një gjë, atë që e kërkon djali i tij për 20 vite me radhë. Ia ke borxh ti, unë dhe të gjithë ne me radhë që t'i tregojmë eshtrat. Kjo është çështje që nuk duhet të marrë fund," tha Braçe. Ky debat i hapur papritur në seancën e djeshme plenare i ka përfshirë të gjithë, ku edhe ministrit të Brendshëm ju kërkuar sjellë Ilir Kumbaron në Shqipëri. "Ky është detyrimi dhe kjo është arsyeja që unë do vazhdoj të jem këtu. Janë krime që kërkojnë me patjetër përgjegjësi, krim pa ndëshkim nuk duhet të ketë më", përfundoi Braçe.

Ish-kryeministri, Sali Berisha ju përgjigj menjëherë Erjon Braçës, duke thënë se nuk kishte asnjë informacion mbi çështjen e Remzi Hoxhës. "Çdo njeri i zhdukur, i vrarë, i ashtu është keqardhje dhe dhimbje, por do sqaroj se nuk më impresionon kurrë nga përdorimi politik i cillido ndodhje gofite. E kam shpjeguar dhe e shpjegoj prapë, rastin e tij për herë të parë ma ka ngritur Adem Demaçi, jam marrë me të gjithë mundësitë e mia, nuk kisha pasur kurrë as informacion as emrin s'e kisha dëgjuar kurrë. U tha se ka marrë pjesë në autobombën e Gligorovit, nuk kam pasur asnjë informacion.

U tha më vonë se ka marrë pjesë në atentatin e Berishës, nuk kam pasur informacion, zero informacion. U tha më vonë se ka folur se është takuar Arkani në Shkodër me Gazideden, Pjetër Arbërori s'ma kishte thënë kurrë asgjë të tillë, ishin sajesa dhe

trillime që donin të përdornin një njeri që mbasi e zhdukën vetë për qëllime politike"-tha Berisha. Ai akuzoi Fatos Klosin, ish drejtues i Shërbimit Informativ Shtetëror, se ka pas-truar dosjet. "U tha se është takuar Berisha me Gligorovin dhe Millosheviçin, kam ten-

tuar t'i bëj Millosheviçit atë që meritonte, pyet pak Fatosin çfarë i kanë thënë, pyet kë ka deklaruar non grata. Nuk mund të isha unë për takime bilaterale me Millosheviçin, ato i bëti ju dhe kjo është e njohur. Unë ika në opozitë pas rebelimit komunist, Shër-

bimin Inteligent e mori Fatos Klosi. Gjënë e parë që bëri Klosi zhduki dosjen e tij. Nëse do ndokush sot janë dëshmitarët që e kanë ndjekur për dy dosje, dosja do ndërtohet plotësisht, mendoni ju se Klosi po e kursente?"-tha Berisha.

DEBATI

Noka-Tahirit: Jep llogari kur është Stafuka



Flamur Noka

Fjala e ministrit të Brendshëm, ka sjellë edhe reagimin e ish-ministrit të Brendshëm të PD-së Flamur Noka. Ai i kërkoi Tahirit, informacion për Enver Stafukën, i zhdukur në Krujë në prill të këtij viti dhe i akuzuar si i përfshirë në vrasjen komisarit Dritan Lamaj.

Berisha: U tha më vonë se ka marrë pjesë në atentatin e Berishës, nuk kam pasur informacion, zero informacion. U tha më vonë se ka folur se është takuar Arkani në Shkodër me Gazideden, Pjetër Arbërori s'ma kishte thënë kurrë asgjë të tillë, ishin sajesa dhe trillime që donin të përdornin një njeri që mbasi e zhdukën vetë për qëllime politike.

Tahiri: Unë e kam për detyrë t'ju përgjigjem dhe t'ju them se Ministria e Brendshme nuk ka më hapësirë për të gjetur përgjegjësi ligjore të situara lidhur me atë ngjarje tek cilido që ka pasur detyrë shtetërore në atë kohë që me veprime konkrete kriminale ka shkaktuar torturën shtetërore të tre personave, një prej të cilëve i ndjeri Remzi Hoxha nuk doli më gjallë.

Noka: Më jep fjalën zoti kryetar.

Meta: Për çfarë e do fjalën

Noka: Për procedurë

Meta: Po nuk e pate për procedurë ta ndërpres fjalën? Një doktor kemi këtu nuk kemi dy

Noka: Të dalë të flasë për një ngjarje kur i ka pasur buzëz me qumësht dhe mbahej me pelena vetë ky mund ta bëjë. Ai duhet t'i sqarojë shqiptarëve ku është Stafuka, dhe a është gjallë? Të zbardhe vrasjen e shokut të tij të ngushtë pasta të flasë për vrasjet kur ka qenë fëmijë. Lë të flasë për trafikun e drogës, edhe për laboratorin e policisë shkencore që kurrë nuk ka ndodhur...



Erjon Braçe

MINISTRI/ KRIMI QË KULMON NË ZYRËN E ISH-PRESIDENTIT BERISHA

Saimir Tahiri: "Do të kërkoj nga Anglia kapjen e Ilir Kumbaros"

Ministri i Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri i është përgjigjur kolegut të tij socialist, Erjon Braçe, dhe ka garantuar se do të kërkojë nga Anglia edhe një herë kapjen e Ilir Kumbaros. Por për ministrin e Brendshëm, dikasteri që ai drejton nuk ka më asgjë se çfarë pune hetimore të bëjë. "Në detyrën që ushtroj kam marrë takim me të birin e Remzi Hoxhës i cili ka kërkuar që Ministria e Brendshme dhe prokuroria e gjyqësori më tej të veprojë që një prej të dënuarve, Ilir Kumbaro të bëhet ç'është e mundur që të vuajë dënimin siç i takon, në Shqipëri. Ministria e Brendshme do bëjë ç'është e mundur që t'i kërkojë autoriteteve angleze gjithçka ka në dorë për të kapur edhe njëherë Kumbaron. Unë e kam për detyrë t'ju përgjigjem dhe t'ju them se Ministria e Brendshme nuk ka më hapësirë për të gjetur përgjegjësi ligjore të situara lidhur me atë ngjarje tek cilido që ka pasur detyrë shtetërore në atë kohë që me veprime konkrete kriminale ka shkaktuar torturën shtetërore të tre personave, një prej të cilëve i ndjeri



Saimir Tahiri

Remzi Hoxha nuk doli më gjallë"-tha Tahiri. Ai shtoi se Sali Berisha, i cili ishte President në kohën kur Shërbimi Sekret rëmbeu dhe zhduku shqiptarin nga Maqedonia Remzi Hoxhën, ka qenë në dijeni për këtë fakt, ndryshe nga sa ai pretendoi. "Ai ishte një krim shtetëror që kulmonte pa asnjë dyshim tek zyra e ish-presidentit. Ish-kryeministri tha që nuk ka qenë në dijeni. Gjergj Jorgo, shef komisarati,

Agim Shehu, zv. ministër, Bashkim Gazidede drejtor i SHIK të gjithë në varësi personale institucionale të Berishës nuk ik kthenin përgjigje prokurorisë për muaj të tërë nëse targa i përkiste apo jo SHIK-ut. Ziso Kristopulli, Avdyll Loshaj dhe Remzi Hoxha janë rëmbyer nga SHIKU për tu çuar në Vajinë të Lezhës, dy prej tyre u torturuan, i treti u torturua dhe nuk doli më gjallë",-tha Tahiri.

TAHIRI

"Ish-kryeministri tha që nuk ka qenë në dijeni, por në fakt është provuar në gjykim që është vënë në dijeni nga familjarët tre ditë pas zhdukjes".

AKUZA

Ish-kryeministri në atë kohë president është provuar në gjykim që është kontaktuar në zyrën e tij nga familjarët e Remzi Hoxhës për t'i kërkuar mëshirë t'i sillnin familjarin gjallë.



Berisha i çoi jashtë të gjithë dëshmitarët e çështjes 'Hoxha'

Ish-kreu i SHISH, Fatos Klosi: "Ata që "përpunuan" Remzi Hoxhën, u pajisën me pasaporta diplomatike"



Fatos Klosi

ESIONA KONOMI
TIRANE

Ish-kreu i Shërbimit Informativ, Fatos Klosi, u përgjigjet akuzave të Sali Berishës, i cili dje në seancën parlamentare, tha se Klosi kishte zhdukur dosjen e tij në SHIK. Në një intervistë për gazetën "Shqiptarja.com", Klosi thotë se ai nuk ka pasur asnjë interes për të fshehur dosjen, por, përkundrazi, shprehet se me ardhjen e tij në krye të SHIK, nisi një hetim për fatin e Remzi Hoxhës, me kërkesë të familjes së këtij të fundit. Në përfundim të hetimit, thotë Fatos Klosi, rezultoi se, Hoxha kishte rënë në duart e SHIK-ut, fillimisht në Tiranë, e më pas ishte çuar në Lezhë, por të gjithë njerëzit e përfshirë në këtë çështje, nuk punonin më në SHIK, dhe kishin ikur jashtë vendit. Në këtë pikë, Fatos Klosi akuzon ish-kryeministrin Berisha, si të implikuar direkt në çështjen "Remzi Hoxha", duke përdorur argumentin se të gjithë dëshmitarët ishin pajisur me pasaporta

diplomatike dhe ishin larguar nëpër Evropë.

Z. Klosi, ish kryeministri Sali Berisha ju ka përmendur sot gjatë seancës parlamentare ku ju akuzon se keni fshehur dosjen tuaj në SHIK. Këto deklarata i bëri kur po diskutohet për çështjen "Remzi Hoxha". A keni ju një koment për këtë?

Atë e lëmë si gjithmonë të flasë ç'të dojë dhe ai e ka guximin të thotë çdo lloj gjëje që mendon se e justifikon. E ka gabim që gjëjen kaq hapur. Ai deri më tani nuk e ka pranuar që ka pasur një dosje për këtë çështje. Deri më tani ata kanë thënë që ne nuk dimë gjë fare, ne nuk kemi pasur lidhje me këtë çështje, shërbimi informativ i asaj kohe nuk e ka njohur këtë njeri, etj. Etj. Kështu janë justifikuar. Tani ai thotë që paska një dosje. Pra, Berisha ka lëvizur nga pozicioni i mëparshëm. Ka gabuar, nuk e di pse. Mbasa ka qenë i pavëmendshëm sot. Ai pranon që paska pasur një dosje?

A ka pasur vërtet një dosje?

Berisha të na thotë pse i përzuri të gjithë njerëzit që kishin të bënin me çështjen e Remzi Hoxhës jashtë shtetit. Si president që ishte në atë kohë, u dha pasaporta diplomatike të tërëve, dhe ata ikën pa viza nëpër Evropë, kryesisht në Angli, por edhe në Belgjikë. Atje u fshehën. Pse? Po të mos kishin gjë për të fshehur, po të ishte kjo një tjetër çështje e thjeshtë, nuk kishte pse ai t'i përzinte këta njerëz. Unë nuk them i detyror, por u dha mundësinë të mos ishin këtu. I ndihmoi të iknin që ata të mos ishin dëshmitarë këtu.

A keni zhdukur ju dosjen tuaj, siç pretendon z. Berisha?

Unë nuk kam fare të bëj me atë çështje, sepse Remziu ka vdekur në 1996, dhe unë jam vendosur në krye të SHIK-ut në vitin 1997. Unë nuk kisha asnjë arsye të fshehja ndonjë dosje. Në çdo rast njerëzit kanë një arsye për veprimet që ndërmarrin. Unë nuk kisha asnjë arsye të tillë. Sapo erdha në detyrë unë ngrita një grup pune, sepse erdhën familjarët e Remzi Hoxhës dhe më kërkuan ndihmë që ne të hetonim se çfarë kishte ndodhur me Remzi Hoxhën. Unë ngrita një grup pune me disa punonjës të shërbimit për të pyetur nëpër rrjetin tonë për këtë çështje. Pastaj u krijua një grup i përbashkët me Prokurorinë e Përgjithshme, dhe arritëm në përfundimin se të gjithë njerëzit që kishin pasur punë me Remzi Hoxhën, (pra u pranua që punonjësit që kishin qenë në SHIK në atë kohë, thanë që: po, Remziu ka qenë në Tiranë në fillim, pastaj përfundoi në Vain të Lezhës. Thanë që: po, "është përpunuar" nga SHIK), por njerëzit që kishin punuar me Remzi Hoxhën, ishin të gjithë jashtë, nuk punonin më në SHIK, kishin ikur me ndihmën e vetë Presidentit të Republikës së asaj kohe. Ai gjëjen hapur kur thotë që unë as e di fare.

Këtë pretendim e ruajti dhe sot z. Berisha...

E ka ditur në vetë të parë problem, madje dhe ka marrë pjesë në zgjidhjen e problemit. Ajo që ka bërë ai personalisht, që ka përgjegjësi, është që ka ndihmuar që fajtorët e kësaj pune, të iknin nga Shqipëria. Nuk e ka aq të kollajtë sa të fshehit pas zhdukjes së dosjes nga ana ime.

Berisha favorizoi Kumbaron, mbyti Remzi Hoxhën më 1995

Ministria e Drejtësisë më 2009 e Gjykata e lartë më 2012 e vonuan



Vonesat e drejtësisë, gjatë qeverisjes së Berishës bënë të mundur largimin e të dënuarit për zhdukjen e Remzi Hoxhës, ish-drejtorin e SHIK të ë Gazidedes, të strehuar në Britani Ilir Kumbaro. Sinjali i qartë u dha që më 2009, kur Ministria e Drejtësisë s' dërgoi dokumentacionin e plotë palës angleze për ekstradimin e Kumbaros bazuar në fletë arrestin e lëshuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda, kërkesë e prokurorit të ndjerë Xhevat Hana. Tre vite më pas s'ri sh gjykata vonoi procedurat, që sollën dhe zhdukjen nga qarkullimi të Kumbaros, i cili tashmë nuk gjendet më në Britani.

Si nisi hetimi i zhdukjes së Remzi Hoxhës, pse ngecën hetimet?

Më 1995, Remzi Hoxha rrëmbehet nga SHIK-u i Gazidedes e dërgohet në Vain të Lezhës, ku nga

toraturat u vdes në duar. Që nga ajo kohë trupi i tij nuk gjendet, ndërsa të akuzuar dhe dënuar janë Ilir Kumbaro me 13 vite burg, Arben Sefgini që përfitoi nga amnistia, Budion Meçe është në koma, Avni Koldashi që është me kartelë gjen-durie. Më parë ata ishin pajisur nga ish-Presidenti Berisha me pasaporta diplomatike, duke lehtësuar lëvizjen e tyre jashtë vendit, dhe sisteminin e Kumbaros me emrin e një kosovari.

Kush i nisi hetimet dhe pse nuk janë në burg autorët...?

Deri më 1997, kishte vetëm heshtje për çështjen e zhdukjes së Remzi Hoxhës. Ish-Presidenti Berisha heshtte, zyrtarët e tjerë i largoheshin përgjigjes dhe vetëm pas ankimit të familjes, nisi hetimi, ndërsa ish-kreu i SHISH Fatos Klosi thotë se s'kishin lënë pas asnjë dokumentacion. Pasi u mblodhën dokumentet e plota çështja prodhoi dhe dënimet përkatëse për 4 të akuzuarit, me fate të ndryshme. Pas 12 vitesh kërkimi Kumbaro gjendet pas emrit Shaqo Shatri dhe vijoi hetimi. Por Arben Sefgini i mbrojt nga Berisha përmes emërimit në Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve dhe kreu i shërbimit të Provs, Meçe në koma, Koldashi një i sëmurë nervor, prokurori Hana në mënyrë misterioze u nda nga jeta.

Kur filloi kaluar i vonesave të ekstradimit...?

Ministria e Drejtësisë më 2009 s'i dërgoi dokumentacionin e plotë palës angleze për ekstradimin e Ilir Kumbaros. Deri në mesin e 2010 ai informacion s'arriti. Ishin pikërisht vonesat në dërgimi e dokumentacionit që i dhuruan Kumbaros lirinë. Ndaj më 18 Dhjetor 2009 Gjykata e Apelit në Londër pushoi çështjen e ekstradimit për Kumbaron, ish-drejtorin e SHIK-ut për Tiranën.

Vonesa tjetër erdhi tre vite më vonë nga Gjykata e Lartë...?

Vonesa nga Gjykata e Lartë për të zbardhur vendimin për ekstradimin, favorizoi Kumbaron që t'i fshehit drejtësisë. Kur gjykata urdhëroi më në fund arrestimin e Kumbaros, ai nuk po gjendej askund. Pasi është vonuar deri në limitet e fundit, gjykata shtyu çështjen deri në dorëzimin e Kumbaros, por ai ishte zhdukur dhe avokati i tij konfirmonte se ai nuk gjendej. Ndërkohë ai kishte vendosur 10 mijë sterlina si garanci, s'ri sh gjenden gjurmët e tij, duke e zhytur më shumë çështjen në mister. Një vonesë e dërgimit të dokumenteve bëri që të dështojë ekstradimi.



Ilir Kumbaro

HESHTJA

Deri më 1997, kishte vetëm heshtje për çështjen e zhdukjes së Remzi Hoxhës. Ish-Presidenti Berisha heshtte. Pas ankimit të familjes, nisi hetimi, ndërsa ish-kreu i SHISH Fatos Klosi thotë se s'kishin lënë pas asnjë dokumentacion, pasi ishin zhdukur.

Rama: Paguam 340 mln USD borxhe të qeverisë Berisha

Qeveria e quajti të suksesshëm buxhetin, por ndeshi në akuzat e opozitës

UDHËTIMET

Erjon Braçe: Jozefina Topalli, 92 milionë lekë dieta brenda vendit

Erjon Braçe ka publikuar një tabelë shpenzimesh, që sipas tij i takojnë ish-kryetares së parlamentit, Jozefina Topalli. Sipas tij, vetëm brenda një viti, Topalli ka shpenzuar 92 milion leke dieta brenda vendit. "92 milion lekë dieta brenda vendit: 179.940 euro dieta, hotel, bileta; 14.872 USD dieta, hotel, bileta", thotë Braçe. Sipas tij, 3 automjetet e Topallit kanë harxhuar një shifër rekord naftë prej 123.2 tonë, duke udhëtuar 1 milionë e 230 kilometra.

SHPENZIMET E TOPALLIT

- 179.940 euro dieta, hotel, bileta
- 14.872 USD dieta, hotel, bileta
- 123.2 ton naftë
- Me një konsum mesatar prej 10 litra për 100 kilometra, bëjnë: 1 230 000 km
- Ose 153 750 kilometra në vit, 12 812 kilometra në muaj, 427 kilometra në ditë

LEONARD QUKU TIRANE

Kuvendi i Shqipërisë diskutoi dje në një seancë maratonë, e cila përfundoi vetëm në orët e para të ditës së sotme, Buxhetin Faktit për vitin 2014. Kryeministri Edi Rama bëri një ekspozitë të të ardhurave në buxhet për vitin 2014, duke përmendur edhe borxhet e lëna nga qeveria e kaluar. Duke folur në Kuvend, kryeministri përmendi investimet në arsim, sport dhe fusha të tjera. Njëkohësisht ai atakoi qeverinë "Berisha" për shpenzime të fryra vetëm gjatë periudhave zgjedhore, për efekte elektorale në vota. "Të ardhurat e buxhetit arritën 26.3% të PBB-së ndërkohë që ju e latë qeverinë me një shifër qesharake 24.1% të PBB-së. Më e rëndësishme akoma në 2014 ne shlyem 340 milionë Dollarë borxhe tuajat, të marra me dhunë nga kompanitë e kontraktuara për punime apo shërbime publike dhe faktikisht filluan procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes shtetit



RAMA

Të ardhurat e buxhetit arritën 26.3% të PBB-së ndërkohë që ju e latë qeverinë me një shifër qesharake 24.1% të PBB-së. Më e rëndësishme akoma në 2014 ne shlyem 340 milionë Dollarë borxhe tuajat

dhe qytetarëve", u shpreh Rama. Sipas tij, shpenzimet e buxhetit vendor janë ndër më të mëdhatë e 10-vjeçarit të fundit nga 10, 42% kanë shkuar për investime në infrastrukturë, dhe fundi i investimeve u rrit 40% krahasuar me vitin tuaj elektorale. Por, për ish kryeministrin Sali Berisha, qeveria s'ka bërë gjë tjetër veçse i ka shkaktuar buxhetit të shtetit një gropë prej 1.2 miliardë dollarë në 1 vit. "KLSH ka thënë 1.2

miliardë sepse, i kthehemi edhe një herë historisë, Edi Rama, në kulisa dhe duke shkëmbuar fund e krye interesat publike firmosi një marrëveshje me CEZ duke i dhuruar vetëm detyrim me fatura të njohura nga vet CEZ-i, siç thotë kompania ndërkombëtare e auditit, mbi 620 milionë euro", u shpreh Berisha. Ai theksoi më tej se qeveria po planifikon edhe blerjen e 3 automjeteve Mercedes-Benz nga 700 mijë euro secili. Akuzavë të Berishës kreu i Komisionit të Ekonomisë Erion Braçe, iu përgjigji me të tjera akuzat. "8 vite në këtë vend është abuzuar deri në krim. Në krim me pasuritë publike, në krim me paratë publike dhe në krim me jetën e qytetarëve. Për sa kohë asnjë nga ata që kanë abuzuar për 8 vite nuk ka dalë para drejtësisë, mua këtu do të më kesh për të folur ditë për ditë për kohën tënde", tha deputeti socialist. Nga ana tjetër, ministri i Financave, Shkëlqim Cani tha se ekonomia shqiptare shfaq shenja për mirësim gjatë 2014-ës, ku vlera e shtuar pati rritje me 2.1%. Sipas ministrit, kjo ishte një rritje e kënaqshme krahasuar me rajonin.

BUXHETI FAKTIK 2014

- Rritja ekonomike **2.1%**
- Të ardhurat **366,7** miliardë lekë, 12% më shumë krahasuar me 2013-ën.
- Realizimi i shpenzimeve **96.2%**
- Shpenzimet kapitale **91.8%** të planit vjetor
- Shpenzimet vendore **14** miliardë lekë
- Shpenzimet korrente **78%**
- Deficiti faktik **81.5%**
- Borxhi publik **69.11%** PBB
- Rimbursimi i TVSH-së **34** miliardë lekë

VENDIMI / KONFERENCA E KRYETARËVE E PËRFSHIN NË KALENDARIN 3-JAVOR

Hetimi i CEZ-DIA, seanca e debatit në 19 nëntor

Parlamenti përfshin në kalendarin tre javor ligjin e propozuar nga opozita, për hetimin ndërkombëtar të marrëveshjes së CEZ. Vendimi u mor paraditen e djeshme në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve. Më vonë u mësu se më 19 nëntor do të

jetë seanca e debatit për këtë çështje. Nisma e opozitës u depozitua në Kuvend në fund të muajit shtator, ndërsa në seancën e 1 tetorit mazhoranca rrefuzoi kërkesën për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të saj, duke vendosur shqyrtimin e çështjes me procedurë normale. Sipas PD-së nga ajo

që e quan "marrëveshje abuzive" dëmi shkoi në kurriz të qytetarëve dhe se përgjegjësit duhet të dalin para drejtësisë. Nga ana e PS-së kërkohet që hetimi të jetë i gjithanshëm nga momenti kur dhe pse u firmos kontrata me CEZ. Demokratët kërkojnë që trupa e prokurorëve të cilët do të hetojnë akuzat e pretenduara si korruptive dhe me indice për përfshirjen e zyrtarëve të lartë në marrëveshjen mes kompanisë CEZ dhe shoqërisë DIA, për mbledhjen e borxheve, të vijnë nga vendet e Bashkimit Europian ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nga ana tjetër, kreu i mazhorancës Edi Rama u shpreh se qeveria shqiptare është e gatshme t'i drejtohet FBI-së për të asistuar prokurorinë shqiptare në hetimin e akuzave. Njëkohësisht me hetimin e akuzave në ngarkim të kryetarit të Kuvendit, Ilir Meta, mazhoranca kërkon që pjesë e hetimeve të jenë edhe ish

SEANCA

"Konferenca e Kryetarëve mori vendimin dje paradite, në nisje të Kuvendit, ndërsa më vonë u mësu se seanca e debatit për hetimin e marrëveshjes CEZ-DIA dhe akuzat do të zhvillohet më 19 nëntor"

kryeministri Sali Berisha dhe ish ministri i tij i Financave, Ridvan Bode. Nga ana tjetër, më 14 tetor Kontrolli i Lartë i Shtetit paditi në Prokurori ministrin e Energjisë Damian Gjijnuri dhe juristen, të cilët përgatitën kontratën e fundit për mblylljen e konflikteve me CEZ me shtetin shqiptar. KLSH deklaroi se dy zyrtarët i shkaktuan arkës së shtetit 479 milionë USD dëm. Ndërsa opozita ka insistuar fort



Konferenca e Kryetarëve

për hetimin ndërkombëtar të marrëveshjes CEZ-DIA, duke se ka ngecur për dërgimin në Gjykatën Kushtetuese të marrëveshjes me qeverisë shqiptare dhe kompanisë çeke, e cila çoi në zgjidhjen

me mirëkuptim të prishjes së kontratës në kohën e qeverisë "Berisha". PD paralajmëroi 6 javë më parë se paralelisht me hetimin, do të depozitonte në Kushtetuese edhe ankimin për rrëzimin e marrëveshjes.

SHPALLJE ANKANDI

Shoqëria Përmbartimore "616/A" shpk, shpall shitjen në ankand për pasurinë "Truall + Ndërtësë", me sip. 250 m², nga të cilat 165 m² ndërtesë, me numër pasurie 14 / 73, vol. 16, fq.34, zk.8582, me adresë: Lagjia Nr.: 4, Pogradec.

Pasuria nxiret në ankand me vlerën fillestare **4.416.000 (katërmilion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë**
Ankandi zhvillohet ne date **04.12.2015**.

Personat e interesuar mund te paraqiten ne adresen Lagjia nr.3, Rruga "Naim Frasheri", Pogradec ose te kontaktojne ne numrin 0697251504 ose ne e-mail: shoqeria616a@gmail.com

Pr.ligji, kryebashkiakët vetëm tre mandate

Mbërrin në Kuvend drafti i ndryshuar, kufizimi nga 2 mandate, shkon në 3 të njëpasnjëshme

ESIONA KONOMI
TIRANE

Kryebashkiakët nuk mund të zgjidhen më për më shumë se 3 mandate. Ky është kufizimi që vendos qeveria, në projektligjin që ka depozituar në Kuvend për "vetëqeverisjen vendore", ku përcakton rregullat e funksionimit të pushtetit vendor pas reformës territoriale. Qeveria hartoi më parë një draft të cilin e kaloi në konsultim publik, ku parashikonte që kryebashkiakët nuk mund të zgjidheshin më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme. Por rrugës, pas konsultimit, qeveria ka vendosur ta ndryshojë draftin, duke lejuar tashmë 3 mandate. Në mesin 59 të ligjit, në kapitullin "Kryetari i bashkisë", thuhet: "1. Çdo bashki ka kryetarin e saj të zgjedhur sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor. 2. Kryetari i bashkisë mund të zgjidhet dhe të ushtrojë vetëm 3 mandate të njëpasnjëshme në krye të bashkisë, me të drejtë rizgjedhjeje. 3. Kryetari i bashkisë, në kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tij, ndihmohet nga një ose më shumë zëvendëskryetarë. Numri i zëvendëskryetarëve caktohet nga kryetari i bashkisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore. Emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhen nga kryetari i bashkisë. 4. Zëvendëskryetari i bashkisë nuk mund të jetë anëtar i këshillit bashkiak." Projektligji forcon rolin e kryetarit të bashkisë si organ ekzekutiv duke i dhënë kompetenca të qarta në drejtim

Decentralizimi

Bashkitë marrin 41 kompetenca në 7 sektorë



Bashkitë e reja do të kenë gjithsej 41 kompetenca, të shpërndara në 7 sektorë, shumica e të cilave janë risi: në sektorin e bujqësisë, kullimit, pujeve, arsimit, sigurisë publike dhe zjarfikësit. Kështu, ë fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse për 14 shërbime. Bashkitë do të kenë 4 funksione në fushën e shërbimeve sociale. Gjithashtu, e në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve rekreative bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e katër funksioneve. Bashkive u shtohen kompetenca në fushën e mbrojtjes së mjedisit, dhe në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pujeve dhe kullotave.

të administrimit dhe organizimit të strukturave të bashkisë, të njësive administrative dhe ndërmarrjeve në varësi, por gjithashtu edhe në drejtim të përfaqësimit juridik në raport me të tretët, veçanërisht në raport me shoqëritë tregtare me kapital të bashkisë, çështje që ka qenë problematike në vitet

e kaluara. "Projektligji vendos bazat juridike për një kapërcim cilësor dhe të qenësishëm në qeverisjen me pjesëmarrjen e komunitetit. Projektligji krijon për herë të parë strukturat komunitare në qytete, në formën e këshillave komunitar të lagjeve dhe mekanizmin e ndërlidhës komunitar, duke plotësuar



Këshilli i bashkiak

kështu një vakum që kishte në hapësirën urbane në raport me fshatin ku ligji i vjetër e parashikonte strukturën e kryetarit të fshatit dhe kryesisë. Qeverisja komunitare është një qasje e re në politikën lokale në Shqipëri sidomos në pjesët urbane dhe sanksionimi me ligj i kësaj strukture do të japi hov nis-

mave qytetare për gjallërimin e jetës në komunitet dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në punët e bashkisë"-thuhet në relacionin drejtuar qeverisë. Ky projektligji pritet të kalojë në komisionet parlamentare, ku mund të pësojë ndryshime të tjera gjatë diskutimeve në Kuvend.

PROPOZIMI


Këshilltarëve të bashkive u hiqet pagesa

Këshilltarët e këshillave bashkiakë nuk do të paguhen më për pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e këshillit sikundërse ndodhte deri më tani. Sipas këtij drafti, këshilltarët nuk do të paguhen sikundërse deri më tani, që merrnin shpërblym mujor në masën 10 % të pagës së kryebashkiakut. Projektligji sjell një ndryshim në funksionin e këshilltarit bashkiak, ku parashikohet që funksioni i këshilltarit të jetë një funksion pa shpërblym, por nga buxheti i bashkisë mund ti rimbursohen shpenzimet e kryera për pjesëmarrjen në mbledhje (psh. shpenzimet e udhëtimit). "Ky ndryshim është në përputhje me përcaktimet e Kartës Evropiane të Qeverisjes Vendore e cila evokon funksionin qytetar dhe komunitar të këshilltarëve si përfaqësues të një kauze publike dhe jo si "funktionar publik" që kryen funksionet kundrejt një shpërblymji për punë"-thuhet në relacionin shoqëruar të këtij projektligji.

LAJME SHKURT

10-vjeçari me trompozë në mëlçi, familjarët në Kuvend për ndihmë

Familjarët e Kristi Mazes, 10 vjeçarit nga Pogradeci, i cili vuan nga një sëmundje e rëndë në mëlçi dhe ka nevojë urgjente për transplant, kanë vijuar me apelin e tyre për ndihmë. Babai i Kristit, Ilia Maze, ndodhej dje para godinës së Parlamentit, me foton e djalit në dorë. Ai tha se Kristi mund të shërohet vetëm jashtë Shqipërisë, pasi në vendin tonë është e pamundur. Mirëpo për të kryer transplantin e mëlçisë, duhen rreth 150 milionë lekë, një shifër e papërbalueshme nga familjarët e Kristit, të cilën thonë se deri tani kanë arritur të mbledhin më ndihmën e qytetarëve rreth 7 milionë lekë.




Pollo në PE: Liria e medias në Shqipëri, degradim

Kryetari i Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Median, Genc Pollo u shfaq tepër kritik për gjendjen e lirisë së shprehjes në vend, pas takimit të posaçëm, që zhvilloi me komisionerin Johannes Hahn, në mjediset e ndërtesës së Komisionit Europian. "Është një shqetësim i përgjithshëm edhe i komisionerit, edhe i Parlamentit Europian, i BE-së në tërësi, për një degradim, përkeqësim të dukshëm të lirisë së medias në Shqipëri. Ndërkohë që kemi të bëjmë me një rregullator, siç është AMA, që nuk është thjesht nën kontrollin e qeverisë, duke vënë aty në shkelje të ligjit një person të afërt me të", tha Pollo për mediat.

Deputeti "kaubojs" Ndocaj: Ja ikonat e Partisë Socialiste

Deputeti "kaubojs" i Lezhës, Eduard Ndoci, vijon të shfaqet pranë socialistëve, pavarësisht se më parë deklaroi se ishte pjesë e PDK-së, e drejtuar nga Nard Ndoka. Pasi mori pjesë në mbledhjen e Partisë Socialiste, ditën e djeshme ai publikoi në faqen e tij në Facebook, një fotografi me kolegët Gramoz Ruci dhe Taulant Balla, të cilët i cilësoi si ikonat e PS-së. Në komentin që shoqëroi publikimin e fotove, Ndoci shkruan: "Gjatë një pauze të seancës parlamentare, një konsultim e bashkëbisedim me ikonat e Grupit Parlamentar të PS".



Ish-të përndjekurit të lidhur me zhinxhirë, protesta para Parlamentit

Ish të përndjekurit politikë protestuan sërish dje para Parlamentit të lidhur me zhinxhirë. Ata kanë kërkuar dëshmipërlimet të dëshmipërblehen për vitet e burgut, hapjen e dosjeve dhe vendosjen e projektligjeve që prekin interesin e tyre, në rindin e ditës të punimeve të Kuvendit. Më pas, ish të përndjekurit u drejtuan Ambasadës Amerikane. Referuar vizitës së pak ditëve më parë të ambasadorit, Donald Lu në burgun e Spaçit, ata kërkuar ndërhyrjen e tij që më në fund kjo shtresë të trajtohet me dinjitetin që i takon. Ish të përndjekurit paralajmëruan grevë urie nëse kërkesat e tyre nuk merren parasysh.

8 muaj pa drita, banorët e Institutit protestojnë para Kuvendit

Dhjetra banorë të zonës së Institutit Bujqësor në Kamëz, protestuan dje para Kuvendit të Shqipërisë. Shqetësimi i tyre mbetet rikthimi i energjisë elektrike, ndërprerë nga OSHEE që në shkurt të këtij viti, për shkak të debite të prapambetura. Banorët kanë përsëritur se janë të gatshëm të bëjnë marrëveshje me OSHEE-në, vetëm me qëllim rikthimin e energjisë. Ata shtojnë se pavarësisht se e kanë kërkuar këtë gjë prej kohësh, askush nga OSHEE nuk i ka degjuar dhe s'ka marrë përsipër zgjidhjen e situatës. Banorët kanë marrë mbështetjen edhe të deputetëve demokratë.

STUDIO PERMBARIMORE "SHKRELA" DO TE ZHVILLOJE ANKANDIN 2 PER PASURITE:

"Pyl", me nr. pasurie 213/1, vol 9, Fq 147, ZK 2891, me sip. 12000 m2, ne Patos -Fshat, Fier. Cimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 2,688,000 Leke.

"Pyl", me nr. pasurie 508/1, vol 9, Fq 152, ZK 2891, me sip. 5900 m2 ne Patos -Fshat, Fier. Cimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 1,321,600 Leke.

"Pyl", me nr. pasurie 216/1, vol 9, Fq 145, ZK 2891 me sip. 9300 m2 ne Patos -Fshat, Fier. Cimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 2,083,200 Leke.

"Pyl" me nr. pasurie 483/1, vol 9, ZK 2891, me sip. 6100 m2 ne Patos -Fshat, Fier. Cimi me te cilin fillon shitja e kesaj pasurie eshte ne vleren 1,366,400 Lekë.

Pasuritë janë në bashkëpunim të familjes Bejleraj dhe të hipotekuar në favor të kreditorit Banka e Bashkuar e Shqipërisë sht.a.

Ankandi 2 zhvillohet më datë 09.11.2015, ora 16.00 në ambientet e Studios Permbarimore "Shkrela" me Adresë: Rruga "George W.Bush", pranë degës së Tatim-Paguesve të Mëdhenj, kati i, Tiranë, Web : www.shkrelaballifsofice.com

Hoffman: S'ka datë për negociatat, integrimi do kohë

Ambasadori gjerman përsërit deklaratën e Merkel: Refugjatët, rrezik tensioni për Ballkanin



Ambasadori Gjerman në Tiranë, Helmut Hoffman

LEONARD QUKU
TIRANË

Kryediploti gjerman në Tiranë, Helmut Hoffman u shpreh dje se nuk ka një datë për çeljen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Ndryshe nga sa deklaroi presidenti i së majtës në Parlamentin Evropian, Gianni Pittella i cili gjatë vizitës së fundit në Tiranë u shpreh se besonte se 2016 ishte viti i çeljes së negociatave, për ambasadorin gjerman nuk ka një moment konkret. Gjatë konferencës "Shqipëria në Procesin e Berlinit: Vlerësime dhe Rekomandime - Vjeshtë 2015", Hoffman tha se me rëndësi është vazhdimi i reformave nga qeveria shqiptare, pasi procesi i integrimit kërkon kohën e duhur. "Procesi i zgjerimit kërkon kohë dhe nuk e dimë kur do të hapen negociatat për anëtarësimin. Po presim progres-raportin që do të dalë në ditët në vijim ku do të jenë edhe rekomandimet përkatëse për procesin e reformave", u shpreh Hoffman. Duke folur për procesin e Berlinit, Hoffman tha se ai i sjell vendet e Ballkanit

Perëndimor më pranë njëri-tjetrit në fusha të ndryshme bashkëpunimi drejt objektivit më të madh të integrimit në BE. "Njëkohësisht, ky proces u dha vende të rajonit, që kanë çështje të pambyllura bilaterale, një kuadër të plotë për trajtimin dhe mbylljen e tyre", theksoi ai. Nga ana tjetër, ambasadori Francez Bernard Fitoussi theksoi nevojën që ky proces ka për një kuadër institucional, burime të mjaftueshme dhe politika të shoqëruara me vizion. Ai tha se "Ballkani Perëndimor është një pjesë e Bashkimit Evropian".

«Procesi i zgjerimit kërkon kohë, nuk e dimë kur do të hapen negociatat për anëtarësimin, por po presim progres-raportin që do të dalë në ditët në vijim»

PROGRES-RAPORTI

Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë do të publikohet javën e ardhshme. Burime pranë delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë pohojnë se ky raport do të bëhet publik më 10 nëntor, të martën e ardhshme. Kjo është hera e tretë që Raport progresi për Shqipërinë shtyhet, i pari ishte planifikuar në fillim të tetorit, i dyti më 24 tetor. Të njëjtat

burime sqaruan për Shqiptarja.com se në raportin progres për Shqipërinë pritet të paraqitet situata problematike në drejtësi.

Shqipëria mori statusin e vendit kandidat në BE verën e kaluar, por Brukseli vuri 5 kushte për çeljen e negociatave. Edhe progres-raporti i këtij viti nuk pritet që ta rekomandojë një gjë të tillë, por nuk mohohej që gjatë 2016-ës, Brukseli të vendosë çeljen e negociatave të anëtarësimin.

ANGELA MERKEL

Pas kancelares Angela Merkel edhe përfaqësuesi i Gjermanisë në vendin tonë, ambasadori Helmut Hoffman paralajmëron rrezikun e tensionit në Ballkan, nisur nga situata e krijuar me refugjatët. Kryediploti gjerman tha se "Ballkani vazhdon të mbetet një zonë tensioni". "Kemi 20 vite që filluan konfliktet gjërat janë përmirësuar, por mbetet një rajon i vështirë për shumë element të ndryshëm. Një është kjo valë e madhe emigrimi. Nuk është se thjesht po ndodh në Ballkan. Dëshiroj të them se mesa shoh projekti i shkëmbimit të përvojave ndërmjet të rinjve mbetet ende një çështje e formulimit të synimeve të mira në letra. Por ajo që na duhet në fakt janë gjëra praktike që të kemi një mekanizëm pune, strukturë me anë të së cilës do të organizohen shkëmbime rinore në një nivel më të lartë", tha ai.


KRIKITA PËR TIRANË- ELBASAN



Mund të kursehej një tunel dhe të mbaronte e gjithë rruga

Ambasadori gjerman në Tiranë, Helmut Hoffman ka gjetur rastin të këshillojë qeverinë shqiptare që të tregohet më racionalë në të ardhmen me projektet infrastrukturore. Gjatë konferencës "Shqipëria në Procesin e Berlinit: Vlerësime dhe Rekomandime - Vjeshtë 2015", Hoffman tha se gjatë udhëtimit nga Tirana për në Elbasan, kishte vërejtur pak lëvizje në këtë rrugë, në një kohë kur rruga ka dy tunele me nga dy korsi. "Shoh shumë pak makina që lëvizin në dy tunelet dhe katër korsitë e tij. Mund të ishte bërë me një tunel dhe dy korsi dhe me paratë e kursyera, mund të ishte mbaruar me kohë edhe segmenti Tiranë-Krrabë, që është një ferr i vërtetë", tha ai.

LAJME SHKURT



Berisha "qan hallet" politike te Nishani

Ish kryeministri Sali Berisha ka lënë dje sallën e parlamentit, për t'iu drejtuar selisë së presidencës, ku ka zhvilluar një takim kokë më kokë me kreun e shtetit, Bujar Nishani. Në takimin që ka zgjatur më shumë se 40 minuta, mësohet të jetë folur për zhvillimet aktuale politike në vend, që kanë

të bërë me reformën në drejtësi, insistimin e vazhdueshëm të ndërkombëtarëve për procesin e dekriminalizimit, situata me ambasadën e Shqipërisë në OSBE etj. Sa herë që ka pasur zhvillime të rëndësishme politike, ish kryetari i PD-së është konsultuar me presidentin e Republikës.

Ministri gjerman në Shqipëri, për të kontrolluar azilkerkuesit

Ministri i Brendshëm i Gjermanisë, Thomas de Maiziere, pritet të zhvillojë sot një vizitë zyrtare në Tiranë. Fillimisht, mësohet se De Maiziere do të pritë rreth orës 12:00 nga homologu i tij shqiptar, Saimir Tahiri. Pas takimit të dy delegacioneve, dy ministrat do të dalin një konferencë të përbashkët

shtypi rreth orës 13:00. Ndërsa, rreth 30 minuta më pas, ministri gjerman do të pritë nga kreu i qeverisë shqiptare, Edi Rama në kryeministri. Ministri gjerman deklaroi dje se do të kryente këtë vizitë në Shqipëri për të parë nga afër kushtet e pritjes së azilkerkuesve të riatdhesuar.



Murrizi i përgjigjet Braçes: Ja lista e emërimeve, dorëzo mandatin

Deputeti socialist Erion Braçe, u shpreh dje në Kuvend se nuk është shkarkuar nga puna asnjë mësues për motive politike. "Nëqoftëse ju gjeni një copë letër ku të jetë urdhri im apo i cilit do prej kolegëve të mi të Lushnjës, që të thotë hiq këtë ose vër atë, unë dorëzoj mandatin sot", u shpreh Braçe. Por, kryetari i degës së PD-së në Lushnjë, Myslim Murrizi, ka publikuar një dokument në Facebook. Sipas tij, në dokumentin origjinal të Zyrës Arsimore të Lushnjës, tregohet se deputetë të mazhorancës, midis tyre edhe Braçe, kanë urdhëruar emërimet e mësuesve. "Pra dorëzoni mandatin që të gjithë", shkruan Murrizi.

Fajtor për shpifje ndaj Ramës, Paloka ankimon vendimin në Kushtetuese



Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Edi Paloka, iu drejtua dje Gjykatës Kushtetuese, ku dorëzoi ankimin për vendimin që e shpalli fajtor për shpifje në procesin me kryeministrin Edi Rama. Paloka tha në një prononcim për mediat se vendimi i Gjykatës së Lartë u mor nën presionin e kreut të qeverisë. Deputeti demokratparalajmëroi se nëse vendimi i Kushtetuteses nuk është në favor të tij, do t'i drejtohet Gjykatës së Strasburgut. Gjykata e Lartë vendosi masën e gjobës prej 200 mijë lekësh të rinj ndaj Palokës, pas padisë për shpifje që kishte ngritur ndaj tij kryeministri Edi Rama.



Bushati në Brazil, marrëveshje për Transportin Ajror

Ministri i Punëve të Jashtme, Ditmir Bushati, po zhvillon një vizitë zyrtare në Brazil. Fillimisht, Bushati është takuar me homologun e tij, Mauro Luiz Lecker Vieira. Në njoftimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, thuhet se "ministri Bushati vlerësoi qasjen e përshkallëzuar të Brazilit kundrejt Kosovës, e materializuar së afërmi me njohjen e dokumenteve të udhëtimit". Në fund të takimit, palët nënshkruan marrëveshjen për Transportin Ajror, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Brazilit. Bushati u takua edhe me zyrtarë të lartë të Brazilit.

Kryetarët e grupeve: Hetimi i CEZ më 19 nëntor në Kuvend

Konferenca e Kryetarëve ka vendosur të fus në kalendarin trejavor të punimeve të kuvendit, projektligjin e PD-së për hetimin ndërkombëtar të CEZ-it. Seanca plenare është vendosur të zhvillohet më 19 nëntor. Në seancën plenare të 1 tetorit, mazhoranca e shtyu me 1 muaj propozimin e demokratëve për hetimin e çështjes CEZ, me argumentin se programi i punës se kuvendit ishte mbyllur deri në 5 nëntor. Megjithatë, përcës procedurës, një tjetër disavatazh për opozitën është edhe fakti që socialistët e kanë bërë të qartë se nuk do ta votojnë propozimin e demokratëve.



Republika e Shqipërisë ka nisur dhe zyrtarisht procesin e emetimit të eurobondit 5 vjeçar. Emetimi vjen vetëm një ditë pasi Ministria e Financave kreu në momentin e fundit pagesën e eurobondin pesëvjeçar, të emtuar në vitin 2010. Sipas njoftimit, shuma e paguar është 322.5 milionë euro, nga e cila 300 milionë euro është vlera e principalit dhe 22.5 milionë euro është kësti i fundit i interesit. Fondet për shlyerjen e pagesës u siguruan: 250 milionë euro nga një kredi (me garanci të Bankës Botërore) e marrë në tregjet ndërkombëtare dhe 50 milionë euro nga instrumente të emetuara në tregun e brendshëm.

NORMA

Sipas agjencisë "Reuters", eurobondi u emetua në një nivel indikativ prej 6, ndërkohë që Deutsche Bank dhe JP Morgan janë menaxherët kryesues. Pritet që ofertat të jenë midis 5 dhe 7%, por në varësi të vullmit të ofruar dhe nevojës së emetuesit, do të pritet në një nivel të caktuar, pra në ofertën më të lartë të pranuar, por niveli i kësaj oferte nuk mund të dihet në këtë moment. Termi "6 low 6s" i përdorur në njoftimin e Reuters nënkupton që norma e interesit të kuponit pritet të jetë, në nivel indikativ rreth 6%. Ky çmim paraprak është "whisper price", pra norma "nën ze" që menaxherët kryesues përsërisin në treg, në hapje të procesit të "book building" – ankandit.

TREGJET

Prej kohësh, menaxheret e

Nis emetimi i eurobondit, interesi rreth 6 për qind

Procesi nis zyrtarisht një ditë pasi Shqipëria pagoi eurobondin pesëvjeçar



Shkëlqim Cani

eurobondit njoftuan qeverinë shqiptare që tregu e ka vlerësuar interesin e eurobondit të ri shqiptar në 6.2%-6.3%, që vlerësohet se është relativisht i lartë, çka bëri që financat të rrinin në pritje, duke ndjekur tregjet. Duke pasur parasysh që normal në tregje janë të ulëta, interesi i lartë reflek-

ton midis të tjerash riskun e financimit alternativ nga tregu i brendshëm, apo instrumente të tjera. Niveli i lartë i borxhit publik luan gjithashtu një rol të konsiderueshëm në çmimin e pritshëm të eurobondit. Financat kanë pasur ecuri të dobët në mbledhjen e të ar-

hurave përgjatë këtij viti, çka rrezikon planet për konsolidim fiskal (uljen e borxhit publik në afatin e mesëm).

EUROBONDI

Në tetor të vitit 2010 për herë të parë shtetit shqiptar emetoi eurobondin me vlerë 300 mln euro me afat maturimi 5 vjeçar dhe interesi 7.5%, që ndër të tjera zëvendësoi një kredi sindikale prej 192 milionë euro të kontraktuar në Maj 2009, me marzh interesi 9.65% (përveç tarifës së angazhimit për udhëheqësit e mobilizimit të kredisë) që ishte marrë nga banka të ndryshme tregtare dhe rregulluar nga Deutsche Bank e Gjermanisë dhe Alpha Bank e Greqisë. Në prill 2014, Ministri i Financave Shkëlqim Cani njoftoi se Shqipëria do të dilte në tregjet ndërkombëtare në 2015-n, kur eurobondi pesë vjeçar të maturon. Ky kurs ishte më i pranueshëm, në raport me mundësinë e kontraktimit të një kredie, që do të shihet vetëm si një skenar rezervë.



Eurobondi

Shqipëria ka nisur zyrtarisht procesin e emetimit të eurobondit 5 vjeçar. Emetimi vjen vetëm një ditë pasi Ministria e Financave kreu në momentin e fundit pagesën e eurobondin pesëvjeçar, të 2010

Interesat

Prej kohësh, menaxheret e eurobondit njoftuan qeverinë shqiptare që tregu e ka vlerësuar interesin e eurobondit të ri shqiptar në 6.2%-6.3%, që vlerësohet se është relativisht i lartë

Pagesa

Fondet për shlyerjen e pagesës u siguruan: 250 milionë euro nga një kredi e marrë në tregjet ndërkombëtare dhe 50 milionë euro nga instrumente të emetuara në tregun e brendshëm



BERZH: Pritet rritje ekonomike me 2.3% në 2015-ën

Raporti më i fundit i BERZH mbi Prespektivat rajonale tregon se rritja ekonomike për Shqipërinë pritet 2.3% gjatë këtij viti dhe 3.3% në vitin 2016. Ndërsa, Gent Sejko, të mërkurën parashikoi rritjen ekonomike me 2.5%. Shqipëria ka përballuar me sukses ndikimin e përmbytyjeve të rënda në fillim të këtij viti, por qeveria po lufton ende për të arritur objektivat e miratuara nën programin e FMN-së, nënvizon raporti i BERZH.




Beqiraj: Të ndërgjegjësohen të gjithë ndaj informalitetit

Zëvendësministria e Financave, Irena Beqiraj zhvilloi dje një vizitë pune në qytetin e Korçës. "Duhet të ndërgjegjësohen të gjithë për luftën kundër informalitetit", u shpreh numri dy i financave shqiptare. Nuk është vetëm çështje e qeverisë, por dhe e shoqërisë. Një reformë nuk i jep frytet që ditën e parë. Reforma ka stadi e veta. Stadi i parë është skanimi. Stadi i dytë ka të bëjë me trajnimet", shtoi Beqiraj. Ajo tha se informimi për taksat në Shqipëri është i ulët.


Qendra e Shërbimeve Publike, nis projekti

Një projekt që shtrihet për zbatim deri në vitin 2020 dhe që kushton 29 milionë euro synon të ndërtimin e Qendrës së Shërbimeve Publike me një naalesë dhe në një vend. Projektmarrëveshja e huasë ndërmjet Shqipërisë dhe BERZH, për këtë projekt, tashmë ka shkuar për miratim në Kuvend. Në kuadër të këtij projekti parashikohet "krijimi përmirësi dhe integrimin e sistemeve informative, përmes digitalizimit dhe përmirësimi të bazës tekniko-informatike".



AlbCHROME

P. Classic Construction, Kati 2, Rr.Budi, ZK8160, Tiranë
Tel.+355 4 242938; Fax. +355 4 259 846;
NIPT: K 11613001 M



BALFIN
Balkan Finance Investment Group

LEADING
PEOPLE AND BUSINESSES
TO SUCCESS

NJOFTIM PUNE

Profil i kompanisë: Balkan Finance Investment Group është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitete për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e hapësirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financim dhe programe besimi për konsumatorët.

AlbChrome është pjesë e Balfin Group e specializuar në industrinë Minerare.

Pozicioni: Menaxher Logjistike dhe i Blerjes se Kromit

Grada: Drejtorit; Logjistikes dhe Njesisë së Blerjes se Kromit

Vendodhja: Zyrat Qendrore Tiranë

Përbledhja e Pozicionit: Menaxheri i Logjistikes është përgjegjës për mire-administrimin e të githë aktiviteteve të shpërndarjes, transportit, furnizimit dhe plotësimit të nevojave operative të njësive të biznesit dhe njësive qendrore Tiranë, duke koordinuar stafin në ndarjen e roleve dhe përgjegjësive dhe mbikëqyr hapat deri në finalizim të procesit.

Detaja dhe Përgjegjësi: Menaxheri i Logjistikes punon pranë zyrave qendrore nën supervizionin direkt të Drejtorit të Departamentit të Logjistikes dhe Blerjes se Kromit dhe nën supervizionin e përgjithshëm të Administratorit të Përgjithshëm dhe kryen këto detyra:

- Përgjegjës për zhvillimin e infrastructures së zinxhirit të furnizimit, duke përfshirë qendrën e shpërndarjes dhe transportit;
- Përgjegjës për arritjen e përmirësimeve në efikasitetin operativ dhe me kostot bazë të përcaktuara sipas buxhetit, në shrytimin e aseteve dhe mallrave për perdorim duke ndërmarrë veprime brenda standardeve të vendosura dhe kontrolluar periodikisht përputhjen e tyre me normat rregullatore;
- Shorjton dhe përditëson strategjitë/procedurat nën objektivin kryesor të zhvillimit të biznesit duke mundësuar funksionalitetin optimal;
- Identifikon/kontraktin furnoret e kromit për blerjen e mineralit për plotësim të nevojës materiale për perpunim në njësitë e biznesit.

- Planifikon dhe mbikëqyr asetet dhe infrastrukturën logjistike;
- Përgjegjës për ndjekjen dhe përbushjen e të gjitha nevojave për transport dhe levizjeve në terren;
- Komunikon statusin e porositve me ndihmën e Uzinave dhe Minerës për t'u siguruar se janë zbatuar grafikët/afatet;
- Planifikon menyrat e transportit, ruget dhe caktimin e ngarkesës për sasi;
- Mbikëqyr statusin e porositve dhe dergesat;
- Monitoron kostot e transportit;
- Lokalizon partneret e biznesit, furnizuesit, prodhuesit me reputacionin me të mire profesional për të bashkëpunuar;
- Asiston Drejtorin e Departamentit në negociimin për çmimin me të mire;
- Zhvillon biznesin duke reduktuar kostot duke fituar kontratat të reja, duke analizuar problemet dhe arritur zgjidhje të reja logjistike;
- Konkludon në menyre efektente dhe sa me praktike emergjencat e lindura;
- Zvendeson Drejtorin e Departamentit në mungesë të tij;
- Kryen funksione të tjera të përcaktuara nga Drejtori i Departamentit dhe/apo Administratori i Përgjithshëm.

Kërkesat:

a. Edukimi: Diplomë Universitare në Menaxhim Biznesi apo rroshia të ngjashme. Përben përparësi nëse është diplomuar në master profesional në drejtimin "Menaxhim Biznesi". Githashtu, përbën avantazh nëse ka kryer studime në kurse profesionale për Prokurim, Logjistike dhe/ose Marketing.

b. Eksperienca e punës:
Eksperienca pune në pozicione të ngjashme jo më pak se 4 vjet;

c. Afësi të tjera:
Afësi të shkëlqyera organizative, duke përfshirë afësi për të planifikuar punën dhe vendosur prioritete;
Afësi të shkëlqyera komunikuese, të zotërojnë etikë pune dhe integritet;

Afësi të shkëlqyera analitike dhe afësi për të zgjidhur në mënyrë efektive problemet;

Afësi për të kryer shumë detyra njëkohësisht dhe afësi për të orientuar detajet;

Afësi shumë të mira ndërpersonale;

Afësi shumë të mira për të ruajtur informacionin konfidencial;

Afësi për të koordinuar punën dhe projektet përkatëse;

Ndjenjë Përgjegjësie;

Njohuri në përpilim kontratash në sipërmarje

Njohuri shumë të mira kompjuterike, sidomos paketat MS Projects dhe MS Office.

Afësi për të punuar në grup dhe për të marrë iniciativë;

Pajisje me patente të vlefshme drejtimi.

Kushtet e punës: Grupi Balfin ofron një paketë benefitesh tërheqëse, duke përfshirë një pagë të drejtë të bazuar në meritat dhe vlerësimin e performancës.

Mënyra e aplikimit*:
Për të aplikuar për këtë pozicion, ju lutem dorëzoni dokumentet e poshtëpërmendura:

- CV të Detajuar;
- Letër Interesi;

tek zyrat qendrore të Albchrome nëpërmjet njëres nga mënyrat si në vijim:

- Me e-mail: hr@albchrome.al
- Duke dërguar me postë në adresën e mëposhtme: Albchrome Sh.PK, Rr. Budi, Classic Construction kati II, Tiranë, Shqipëri.

Afati i dorëzimit: 12.11.2015

*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë sipas ligjit Nr 9887 vendosur nga Kuvendi i Shqipërisë për "Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

LORENC RABETA
TIRANE

Shkeljet në tenderat e blerjes së mjeteve të blinduara dhe 5 helikopterëve për ushtrinë, kanë bërë që Kontrolli i Lartë i shtetit të kallëzojë në prokurori 12 zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes. Në një njoftim për shtyp KLSH bënte me dije se për tenderin e mjeteve të blinduara, drejtuesit kanë rritur me 220 mijë euro çmimin e blerjes së tyre nga një kompani private. Ndërsa në rastin e tenderit për blerjen e helikopterëve, drejtuesit e ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes kanë likuiduar 639,794 euro më shumë se detyrimi kontraktual. "Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka përcjellë organit të Prokurorisë dy kallëzime penale për 12 punonjës të Ministrisë së Mbrojtjes, të akuzuar për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", parashikuar nga nenet 248 dhe 258 të Kodit Penal", thekson njoftimi.

TË KALLËZUARIT

Më konkretisht, KLSH i ka përcjellë organit të Prokurorisë dy kallëzime penale për E.Ç. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Standarteve të NATO-s dhe Modernizimit, A.Sh. me detyrë Shef i Sektorit të Hartimit të Projekteve, M.K. me detyrë Shef Shtabi në Policinë

220 MIJË EURO
Në një njoftim për shtyp KLSH bënte me dije se për tenderin e mjeteve të blinduara, drejtuesit kanë rritur me 220 mijë euro çmimin e blerjes së tyre nga një kompani private



639,794 EURO
Ndërsa në rastin e tenderit për blerjen e helikopterëve, drejtuesit e ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes kanë likuiduar 639,794 euro më shumë se detyrimi kontraktual

zbatimin e ligjshmërisë në marrjen në dorëzim të "Kiteve të helikopterëve" dhe pasqyrimin e tyre në evidencën kontabël, nga personat përgjegjës, janë konstatuar një sërë shkeljesh të dispozitave përkatëse ligjore e nënligjore, të cilët konsistojnë në mospërbushje të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të dispozitave të mësipërme ligjore dhe kontraktive:

Nga auditimi rezultoi se gjatë zbatimit të kontratës së tenderit me objekt "Furnizimi me 5 helikopterë të mesëm shumëvlerësh" e ndryshuar, kompanisë fituese i janë likuiduar katër kite me vlerë 3,458,142 euro, ndërkohë që vlera e katër kiteve sipas dokumentacionit të bërë hyrje është në 2,764,348 euro, ose 639,794 euro më pak.

BLINDET

Nga auditimi mbi zhvillimin e procedurës ushtarake me "Procedurë me negociim të drejtpërdrejtë" me objekt: "Blerje mjete të blinduara për policinë ushtarake me kompaninë Iveco s.p.a.", me vlerë prej 1,420,000 Euro, për vitin 2014, në Ministrinë e Mbrojtjes", rezultoi se nga ana e grupit të punës janë bërë ndryshime të specifikimeve teknike, të ndryshme nga kërkesa e njësisë ushtarake, si pasojë e të cilave ka një rritje të pajustifikuar prej 220,000 Euro nga projekt ideja fillestare e propozuar nga Komanda e Policisë Ushtarake.

Blindet e helikopterët, 12 vetë në prokurori

KLSH: Ushtarakët e zyrtarët, shkelje me pagesat dhe kontratat për dy tenderat për armatimet

B.D. me detyrë shef logjistike në Policinë Ushtarake B.B. me detyrë Komandant i Kompanisë operacionale në Policinë Ushtarake N.G. me detyrë specialist në sektorin e hartimit të projekteve, E.D. me detyrë specialist në sektorin e hartimit të projekteve, në lidhje me shkeljet e konstatuara në tenderin me objekt "Blerje mjete të blinduara për polici-

në ushtarakë me kompaninë Iveco s.p.a.", duke rritur në mënyrë të pajustifikuar, fondin limit nga 1,200,000 Euro të parashikuar në projektin fillestar të propozuar nga Komanda e Policisë Ushtarake, në 1,420,000 Euro, ose 220,000 euro më shumë; si dhe M.M. me detyrë Z/V Komandant i KFA, O.N. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit

të Financës së KFA, S.Ç. me detyrë ish Komandant i Repartit Ushtarak nr. 3006, A.L. me detyrë ish Komandant i Repartit Ushtarak nr. 3006, dhe L.A. me detyrë ish Shefe e Financës e Repartit 3006, në lidhje me shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës së tenderit me objekt "Furnizimi me 5 helikopterë të mesëm shumëvlerësh",

të cilët nëpërmjet veprimeve të kryera prej tyre, i kanë likuiduar kompanisë private katër kite me vlerë 3,458,142 euro, ose 639,794 euro më shumë, ndërkohë që vlera e katër kiteve sipas dokumentacionit të bërë hyrje është 2,764,348 euro.

HELIKOPTERËT

Nga auditimi lidhur me

REZULTATET TREGOJNË SE GRUPI BANKAR GREK ËSHTË FINANCIARISHT I FORTË DHE I SHËNDËTSHËM

Alpha Bank në Greqi kalon me sukses vlerësimin e gjithanshëm

Alpha Bank në Greqi publikoi rezultatet e provës së qëndrueshmërisë (stress test-it), i cili u realizua për katër bankat sistematike greke. Kjo provë qëndrueshmërie u krye për të vlerësuar kërkesat minimale për kapital (kapitali i zakonshëm i shkallës së lartë) në grupin e CET1 nëpërmjet:

- **Rishikimit të cilësisë së aktiveve**, nëpërmjet vlerësimit të përshatshmërisë së kapitalit CET1 për vlerën e aktiveve në një datë të dhënë, rregullimit për shkak të provizioneve, rregullimit vlerësues të kredisë dhe rishikimit të vlerës së drejtë; dhe

- **Sprovës së qëndrueshmërisë**, me qëllim vlerësimin e aftësisë ripërtëritëse të Bankës përkundrejt zhvillimeve të mundshme negative dhe vlerësimin e mundësive që risqet sistematike të shtohen gjatë situatave të vështirësuar;

Vlerësimi i gjithanshëm që mbuloi periudhën nga korriku 2015 deri më dhjetor 2017 dhe sprova e qëndrueshmërisë nxjerrin në pah dobësitë e mundshme të pakorigjuara të zbuluara në provat e mëparshme, ndihmojnë në përfundimin e shpejtë të rregullimeve në sektorin bankar

si dhe ndihmojnë në rritjen e besimit të publikut të gjerë ndaj këtij sektori.

Sprova e qëndrueshmërisë u zhvillua duke marrë në konsideratë dy skenarë, skenarin "bazik" dhe skenarin makroekonomik negativ.

Në përputhje me vlerësimin e gjithanshëm dhe mbështetur në skenarin bazik raporti i CET 1 minimum ishte 9.5%, shumë më lartë se një vit më parë që ishte vetëm 8%. Në skenarin e makroekonomik negativ raporti i CET-1 ishte caktuar si minimum 8%, krahasuar me 5.5% që ishte një vit më parë.

Ndër grupet e suksesshme bankare të eurozonës rezultoi edhe grupi i "Alpha Bank" i cili ka arritur që pas korigjimit të aktiveve në skenarin bazik raporti i kapitalit prej 8.98% të jetë shumë afër normës minimale të vendosur prej 9% gjë që do të thotë se mungesa e kapitalit është shumë e vogël, vetëm 263 milionë euro, një shumë më e ulët se ajo përkatëse e bankave të tjera sistematike të Greqisë dhe shumë vendeve të tjera.

Këto rezultate, për një grup bankar që operon në mënyrë të suksesshme në tregje ndërkombëtare, u ndikuan më shumë nga ndryshimi i "rregullave të lojës", nga ndryshimet në normat minimale të përcaktuara

në skenarin bazik (9.5% nga 8%) dhe në skenarin negativ (8% nga 5.5%).

Për më tepër, analiza e kryer tregon se pozicioni i Alpha Bank është përmirësuar më tej për shkak të injektimit të 1.2 miliardë euro kapital gjatë vitit 2014, veprim me të cilin banka ka bërë të mundur riberljen e aksioneve preferenciale të shtetit grek me një vlerë prej 940 milionë euro.

Në lidhje me këtë vlerësim të gjithanshëm, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i grupit Alpha Bank, z. Demetrios P. Mantzounis u shpreh: "Në kuadër të një mjedisi shumë të paqëndrueshëm, ne kemi ruajtur të paprekur kapacitetet tona operacionale. Të ardhurat tona përpara provizioneve arriten në vlerën 872 milionë Euro, të shtuara me 9% krahasuar me vitin e mëparshëm, për shkak të kostos së ulët të depozitave dhe pakësimit të shpenzimeve operative të Bankës me 8% nga viti në vit. Duke pasur mbulim me mjete të numërueshme të huave me probleme dhe duke pasur në bilanc provizione me vlerë 15.2 miliardë euro – ne jemi të vendosur të vazhdojmë strategjinë tonë në përmirësimin e drejtimit të huave me probleme në portofolat me shumicë dhe atyre me pakicë dhe për të maksimizuar mundësinë e rikuperimit të tyre.

Ne vazhdojmë të jemi plotësisht të an-

gazhuar për të përbushur me sukses rikapitalizimin brenda fundit të vitit 2015, si dhe për të vazhduar zbatimin e objektivave të planit të rstrukturimit. Zbatimi i reformave strukturore dhe përmirësimi i treguesve ekonomikë, e vendosin Alpha Bank në një pozicion të favorshëm për të përfunduar nga besimi i përtëritë dhe stabiliteti në sektor."

Ky vlerësim i gjithanshëm kishte si qëllim sigurimin e tregjeve se sistemi bankar në përgjithësi, dhe grupe të caktuara bankare në veçanti, kanë aftësinë e duhur për të furnizuar ekonominë reale me financime të mjaftueshme edhe në situata negative apo të pafavorshme. Rezultatet për operacionet në të gjithë Europën, përfshirë Shqipërinë, i japin Alpha Bank pozicionin e duhur për tu konsideruar një bankë e qëndrueshme në vend si dhe një partner i besueshëm për të gjithë ato familje dhe biznese që të besojnë depozitat si dhe të kërkojnë financime.

Për sa i përket Alpha Bank Albania, ajo operon në Shqipëri prej vitit 1998 dhe nëse i referohemi statistikave të Alpha Bank Albania Sh.A. mund të themi se deri në Qershor 2015 zotëronte një portofol kredie prej 38 miliardë lekë dhe depozita të klientëve në vlerën e 60 miliardë lekëve.

NE TETOR

Ndotja, ja gjobat që ka vendosur Bashkia

Më shumë gjoja për bizneset më pak për individët.
Kryebashkiaku Veliaj: Aksioni do vazhdoj

DRIÇIM ÇAKA
TIRANË



Aksioni i insitucioneve të Bashkisë së Tiranës për gjobitjen e individëve apo bizneseve që ndotin ambientin apo zaptojnë hapësira publike, ka bërë që vetëm në muajin tetor të vendosen 2300 gjoja. Gjobat janë vendosur nga Policia Bashkiake për shkelësit e qarkullimit dhe për ndotje apo zënie të hapësirave publike. Të dhënat e publikuara nga kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, tregojnë arsyet e vendosjes së këtyre gjobave. Në materialin e postuar në rrjetin social Facebook, Veliaj sqaroi se gjatë muajit tetor janë vendosur 1600 gjoja për shkelje të rregullave të qarkullimit dhe 700 gjoja për ndotje dhe zënie të hapësirave publike. "Në një qytet të pastër, jo tolerancë për ndotësit! 2 mijë vetë gjoja, që 1 milion qytetarë të jetojnë pastër! Policia Bashkiake dhe Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit janë çdo ditë në terren për t'i thënë JO ndotësve, zaptuesve të hapësirave publike dhe atyre që thejnë rregullat e qarkullimit", shkruan Veliaj në rrjetet sociale. Ai apelon ndaj të gjithë qytetarëve të kontribuojmë për mbajtjen e qytetit të pastër. Kryetari i Bashkisë gjithashtu thekson nevojën e lirim të hapësirave publike dhe pastrimit të Tiranës nga zhulli 4-vjeçar.

PËR QYTETARËT

Masat e gjobës variojnë nga 500 deri në 500 mijë lekë të reja. Gjobat më të ulta janë vendosur për qytetarët që ndotin ambientin. Aksioni për ndërtimet pa leje, ulen në mënyrë drastike shifrat



SENSIBILIZIMI

Ndryshe nga fillimi i aksioni, bashkia në muajin tetor ka vendosur një numër shumë të ulët gjobash, për ata që urinojnë në ambientet publike. Vendosja e banjove publike në Tiranë ka sensibilizuar qytetarët

Tetor Policia Bashkiake vendosi 2300 gjoja gjithsej!

1600 GJOBA PËR SHKELJE TË RREGULLAVE TË QARKULLIMIT

700 GJOBA PËR NDOTJE DHE ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

QË QYTETI TË MBANET PASTËR, DUNEJ TË KONTRIBUOJMË TË GJITHË. LIRIJMË HAPËSIRAT PUBLIKE DHE PASTRIMIN TIRANË NGA ZHULLI 4-VJEÇAR!

SA ESHTË MASA E GJOBAVE

- Hedhja e mbeturinave në rrugë ose jashtë kontenerëve 5.000 lekë
- Kryerje e punimeve pa leje 500.000 lekë + shpenzimet e prishjes
- Shfrytëzimi i paligjshëm i hapësirave publike 20.000 lekë + 300 lekë/m2
- Vandalizmi i pronës publike 20.000 lekë
- dëmtim, bllokim, vjedhje pusete urinim/ pështyrje /grafiti në rrugë, dëmtim i shtyllave të ndriçimit/ ndriçuesve, dëmtim pemësh
- Ndotje e rrugëve nga automjetet e rënda (baltë, vaj, llaç) 10.000 lekë
- Djegja, zhvendosja, dëmtimi dhe vjedhja e kontenerëve 20.000 lekë
- Ndotja dhe mospastrimi i ambientit pas aktivitetëve 5.000 lekë

GJOBAT

Ndryshe nga fillimi i aksioni, bashkia në muajin tetor ka vendosur një numër shumë të ulët gjobash, për ata që urinojnë në ambientet publike. Vendosja e banjove publike në Tiranë ka sensibilizuar qytetarët. Më shumë gjoja

janë vendosur për furgonët dhe automjetet e rënda të cilat nuk kanë respektuar sinjalistikën rrugore që ka vendosur bashkia. Për ndotje janë vendosur me dhjetra gjoja ndaj bizneseve të cilat nuk kanë respektuar urdhrin e bashkisë. Ndaj qytetarëve janë vendosur

rrathë 50 gjoja për hedhje të mbeturinave, të cilat janë filmuar nga kamerat publike.

MASA E GJOBËS

Masat e gjobës variojnë nga 500 lekë deri në 500 mijë lekë të reja. Gjobat më të ulta janë vendosur për qytetarët që

ndotin ambientin apo urinojnë në ambiente publike. Ndërsa masat që ka miratuar bashkia parashikohen se gjobat fillojnë nga 5 mijë deri në 500 mijë lekë, por në disa raste masa e tyre ka qënë më e ulët, kur ka patur shkelje vetëm nga 1 qytetarë.

LAJME SHKURT



Dëmtimi i pllakatës së Sulejmanit, "T'i dalim për zot historisë"

Ambasadori i Turqisë në Shqipëri Hydajet Bajraktar ka komentuar dëmtimin e pllakës osmane në kalanë e Lezhës. "Është një veprim ndaj një veprë historike. Nga njëra anë restaurohen vepra të ndryshme historike. Nuk e kam fjalën për Shqipërinë, kudo në çdo vend duhet t'i dalim për zot historisë, duhet t'i kushtojmë rëndësi historisë. Është historia e në të gjithëve dhe është një vlerë kulturore", u shpreh ai për mediat, ndërsa shtoi se detajet e tjera shtoi se do t'i sqarojë me ministrin e Kulturës. Ambasadori turk ishte në Shkodër, ku u takua me prefektin Paulin Radovani dhe kryebashkiaken Voltana Ademi.

Prezantohet manuali i tarifave për shërbime në planifikim territori

Në Vlorë u prezantua dokumenti "Manuali i tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", nga Ministria e Zhvillimit Urban. Zëvendësiminori i Zhvillimit Urban, Gjon Radovani, tha se ky dokument "ndryshon dhe zgjeron bazën e tarifave të miratuara me aktet e mëparshme ligjore dhe propozon tarifën e reja që subjektet duhet të paguajnë kundrejt shërbimeve të marra në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim". Në takim ishin të pranishëm përfaqësues të bashkive Vlorë, Sarandë, Himarë, Delvinë, Konispol, Fiqiq dhe Përmet.

Infermierët që janë në punë me leje provizore, testohen në nëntor

Të gjithë infermierët, mamitë, fizioterapeftët, teknikët e imazherisë, teknikët e laboratorit, logopedistët, të cilët janë në marrëdhënie pune me Leje Provizore, duhet të hyjnë në Provim Shteti në sezonin nëntor 2015. Urdhëri i Infermierit bën më dije se "bluzat e bardha" do të testohen në Agjencinë Kombëtare të Provimeve dhe datat do të përcaktohen nga AKP. Pyetjet e provimit gjenden në portalin online të Agjencisë Kombëtare të provimeve dhe kanë të bëjnë vetëm me fushat që bluzat e bardha kanë studjuar apo kanë punuar.



Siguria e digave, BB: Projekti mund të kërkojë 12 milionë euro shtesë

Projekti i sigurisë së digave që po implementohet nga KESH, ka kaluar në një vlerësim të Bankës Botërore. Në raportin e BB-së, që i përket fundit të territorit, thuhet se ky projekt ka nevojë për 12 milionë euro shtesë. Sipas BB-së, ka pasur një moskordinim sa i përket procedurave të tenderimit në të kaluarën, çka ka sjellë dështimin me tre herë. "Rehabilitimi i portave shkarkuese është në proces ritenderimi. Pas përpjekjes së tretë u vendos që të financohej vetëm pjesa e portave shkarkuese në Koman dhe Fierzë. Ka nevojë për fonde shtesë prej 12 milionë euro", thuhet në raportin vlerësues të BB-së.

Sejdini-Stançiq: Sllovenia, projekte për mjedisin në Elbasan



Kryetari i Bashkisë së Elbasanit, Qazim Sejdini, ka pritur dje në një vizitë zyrtare ambasadorin e Sllovenisë në Tiranë, Lea Stançiq. "Ne do të bashkëpunojmë konkretisht me Elbasanin për projekte mjedisore", tha në një deklaratë për mediat ambasadorja sllovene. Ndërsa, kryebashkiaku i Elbasanit tha se "takimi me ambasadorin ka të bëjë me disa projekte shumë të rëndësishme për ambientin, duke filluar nga rihabilitimi i fushës së mbetjeve në Bradashesh, tek impianti i ujërave të zeza, rihabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, një projekt për energjinë e rinovueshme diellore, etj".

Banorët kundër vendosjes së taksës për rrugën e Kombit

Banorët e Kukësit kundërshtojnë të paguajn taksën që do të vendoset, pas koncesionit që pritet të jepet për mirëmbajtjen e këësaj rruge. Ata shprehen se ata kanë paguar njëherë taksat për këtë rrugë. Sipas banorëve, Kukësi është zona me papunësinë më të lartë, me varfërinë më të madhe dhe me numrin më të

madh të emigrimit ekonomik drejt Perëndimit, ndaj një taksë më shumë do t'i dëmtoje ata. Nga fillimi i vitit të ardhshëm rruga e Kombit do të jetë me pagesë. Sipas Ministrisë së Transporteve, për çdo makinë tarifa mund të jetë 5 euro, ndërsa për banorët e zonës mund të ketë lehtësira.

U plagos në Bathore, i riu humb jetën në spital

Atentati me armë zjarri i dy ditëve më parë, vdes dje Valter Kolovari

ELTON QYNO
TIRANË

Ka ndërruar jetë në spital një prej të plagosurve të ngjarjes së mbrëmshme në Bathore. Valter Kolavari ka ndërruar jetë në spital pas ditën e së enjtes ndërkohë që kushëri i tij ndodhet ende në reanimacion. Ngjarja ndodhi për shkak të një "prishje hespesh" mes tre personave të përfshirë në një kontrabandim njerëzish drejt Anglisë. I plagosur është i vëllai i viktimit Bashkim Kolavari ndërkohë autori është Elson Daci, i cili është shpallur në kërkim


nga policia e kryeqytetit. Dy të rinjtë kushërinj me njëri-tjetrin mbetën të plagosur si pasojë e një konflikti me armë zjarri në një lokal në qendër të Bathores. Konflikti sipas burimeve nga policia për "Shqiptarja.com" ka ndodhur për shkak se të tre personat ishin pjesë e një grupi që kontrabandononte njerëz drejt Anglisë, ndërkohë policia ka shtuar si pistën kryesore të hetimit "prishjen e hesapeve mes tyre".

KLANDESTINËT NË ANGLI
Ngjarja ka ndodhur mbrëmjen e së mërkurës për motive të prishjes së pazareve të klandestineve. Policia ka arritur të identifikojë au-

SHKAKU

Një vit më parë Xhelal Daçi është dyshuar se ka sjatur vendosjen e një granate në derën e shtëpisë së tij, për të krijuar idenë se familja e tij ndihet e rrezikuar. Gjithçka mendohet se është bërë për të ndihmuar djalin e tij që t'i krijohet lehtësira për azil

torin e dyshuar si Elson Daci. Valter Kolavari dhe kushëri i tij Bashkim Kolavari kanë mbetur të plagosur nga ngjarja. Mësohet se një prej tyre ndodhet në gjendje



Ekspertët e policisë në vendin e ngjarjes

kritike për jetën dhe se janë të moshës 26 dhe 27 vjeç. Të dy të plagosurit ndodhen në spital ku po marrin mjekimin e nevojshëm ndërkohë që policia është vënë në ndjekje të autorit të dyshuar Daçi.

INSKENIMI I ATENTATIT

Elson Daci nuk është i panjohur për policinë e Tiranës pasi një vit më parë babai i tij Xhelal ka inskenuar një ngjarje kriminale me qëllim të vetëm që të krijonte mundësinë djalit të tij, për të ikur si azilant në Angli.

Një vit më parë Xhelal Daçi është dyshuar se ka sjatur vendosjen e një granate në derën e shtëpisë së tij, për të krijuar idenë se familja e tij ndihet e rrezikuar. Gjithçka mendohet se është bërë për të i krijuar lehtësira për azil në një nga vendet e BE-së, teksa ai është në kërkim ndërkombëtar për trafik droge. Kësisoj, Elsonit do t'i krijoheshin lehtësira në fitimin e azilantit politik, pasi ai e kishte kërkuar azilin në një nga vendet e BE-së.

KRIMI NE ITALI

Pensionisti që vrau shqiptarin: Nëse merrem me diçka, hyj në politikë



65 vjeçari italian, i cili qëlloi për vdekje 22 vjeçarin shqiptar në Milano, nuk i ndal provokimet. Pensionisti italian Francesco Scignano, i cili vijon të jetë nën hetim, ka deklaruar se shqiptarin e qëlloi në kuzhinën e shtëpisë së tij. Ndërsa, hetimet kanë zbuluar se 65 vjeçari e qëlloi të riun në shkallët jashtë shtëpisë. Madje, në kuzhinë nuk është gjetur asnjë shenjë gjaku. I thirrur sërish për tu marrë në pyetje, ai tha se e qëlloi shqiptarin për të mbrojtur vetin dhe familjen. Pas kësaj seance, 65 vjeçari ka deklaruar për "Euronews" se nëse do merrej me diçka, do futej në politikë.




AUTO MASTER

DEALER I RI PËR FIAT DHE JEEP NË SHQIPËRI

Prezantim i tre modeleve të reja

JEEP RENEGADE

Vendosmëri, aftësi dhe dëshirë për të qenë pjesë e një ekipi solid: këto janë përberësit më të rëndësishëm në krijimin e Jeep Renegade, automjetit i parë i Fiat Chrysler Automobiles, i projektuar e ndërtuar sëbashku nga inxhinierët dhe projektues italianë dhe amerikanë, si dhe modeli i parë në historinë e kësaj markë që prodhohet në Itali, në fabrikën e rinovuar SATA në Melitri (Basilicata). Një Jeep tërësisht i ri, që është rezultat i kombinimit midis dizajnit, funksionalitetit dhe eksperiencës nëudhëtimet jashtë rrugë, që historikisht ka qenë dhe është veçori e markës amerikane: që prej 74 vitesh është sinonimi i lirisë dhe udhëtimeve 4x4, ndërsa stili dhe veçoritë dinamike janë shenja dalluese të makinave italiane nëpër botë.

Jeep Renegade është një model i pajisur me një personalitet të fortë stilistik. I shkathët dhe me hapësirë, është i përsosur për lëvizjet brenda qytetit dhe falë aftësive për offroad, është i gatshëm të eksplorojë shtigjet të reja jashtë rrugë. Renegade vlerësohet për hapësirën më të madhe brenda kabinës për kategorinë e saj, cilësië dinamike të përsosura në asfalt dhe aftësië të paarritshme jashtë tij.

Me modelin e ri Renegade, Jeep hyj në një nga kategoritë më rritjen më të shpejtë në industrinë e automobilizimit – tregun e modeleve SUV të vogla.

FIAT 500

Tetë vite më vonë dhe pas 1,5 milion njësive të shitura në të gjithë botën, pistari i kalon modelit të ri 500, me të cilin Fiat po përgatitet të ndërmarre sfida të reja në këtë segment, pa harruar rinjët e saj të hershme. E krijuar nga **Centro Stile Fiat**, makina ka një pamje të jashtme dhe një arredim të brendshëm të rifreskuar, por që mbetet në mënyrë të pagabueshme brenda filozofisë stilistike të 500. Nuk është rritur në përmasa, por është pasuruar me më shumë teknologji, njësi motorike të reja dhe mundësi të shumta personalizimi: vetëm në këtë mënyrë një ikonë mund të evoluojë dhe të rafinojë cilësië të saj, që e kanë kthyer në një kryevepër të dizajnit.

Kurajoze dhe tërheqëse, 500 e re ka më shumë se 1900 detaje inovatore, të gjitha të dizajnuara për t'i shtuar origjinalitetin dhe për ta bërë stilin e saj edhe më të rafinuar. Fenerat janë krejtësisht të rinj me drita LED për ndriçimin gjatë ditës. E re është edhe pamja e grupeve optike të pasme, gjama e ngryrave për karrocërinë, dizajni i kroskositit si dhe materialet e përdorura: përditësimi është thelbësor, por besnik ndaj frymës së mirënjohur të 500. Jo rastësisht, kjo ikonë e Fiat është manifest i një koncepti të ri mobiliteti; është një "revolucion i butë" që përhapet në rrugët e botës, një fenomen që duket se mund të bashkojë të kundërtat.

Pra, sot 500 e re është rifreskuar nën frymën e vazhdimësisë estetike dhe evolucionit teknologjik. Kjo është formula magjike e 500, modeli i vetëm i aftë të përziejë të kundërtat në mënyrë koherente: është ekskluzive, e megjithatë e arritshme, është një "best-seller" global, me një zemër thellësisht italiane, është një produkt elegant, që ofron shumë argëtim. Është një makinë krejt personale, edhe pse janë shkur më shumë se 1,500,000 të tilla. Për më tepër, 500 e re kombinon teknologjinë dhe ndjenjat për të rivendosur veten në majë të segmentit të saj në çdo këndvështrim.

FIAT 500X

E bukur por me karakter, makina e re eksploron një dimension krejt të panjohur për një 500, ku stili elegant krejtësisht italian, "vesh" si në sallonet e Haute Couture, një makinë në thelb komode, e aftë për performanca të larta dhe gjithnjë e lidhur me botën e jashtme: **Kjo është fuajja X e bukurisë dhe ky është shpirti i 500X.**

Një trashëgimtare e Fiat 500 të vitit 1957 – referenca stilistike e fenerëve rrethorë dhe logo klasike e rrethuar nga "mustaquet" e kromuara në pjesën ballore të makinës është e qartë – ky crossover i ri i Fiat zgjerohet edhe më tej familjen e 500, që tashmë përfshin modelet 500, 500C, 500L, 500L Trekking dhe 500L Living – makina me karakter dhe veçori të ndryshme, që ndajnë të njëjtat rrënjë: një ikonë si Fiat 500.

Fiat 500X është një crossover jo thjesht për shkak të emërimit, por sepse i drejtohet një morie klientësh të ndryshëm, me kujt apo femra, të moshave të ndryshme, me nevojë dhe dëshirë të ndryshme. Për këtë arsye, simboli "X" përfaqëson një udhëkryq mes shumë segmenteve të ndryshme, të populluar nga të rinjtë dhe më të pjekur, adhurues të së bukurisë apo njohës të thellë të karakterit.

E projektuar nga **Centro Stile Fiat**, 500X e re përfaqëson një dimension të ri dhe të pagabueshëm të 500, në të cilin ndërlikohen stili ikonik i modelit të mirënjohur italian me konceptin praktik të një crossover-i modern, së cilave i shtohen edhe aftësië të tepër të mira në udhëtimet jashtë asfaltit.

Me një dizajn të pagabueshëm "Made in Fiat", 500X ofron fleksibilitet, praktikitet dhe cilësi, të gjitha të përmbledhura brenda përmasave të saj kompakte. Kabina me hapësirë të bollshme sipak për përdorimin e materialeve cilësore, si dhe për teknologjinë më të sofistikuar në shërbim të sigurisë, komfortit dhe mirëqenies në bord. Fiat 500X është një makinë "casual" dhe argëtuese, të cilën mund ta "veshësh" çdo ditë, si një veshje tejet origjinale që ju jep liri shprehjeje dhe pasqyron personalitetin tuaj, falë edhe mundësië të shumta së personalizimit, nëpërmjet opsioneve shtesë.





Në vitin e 11 të saj, Akademia KULT sjell mbrëmjen e madhe Gala të ndarjes së Çmimeve KULT, në sallën e madhe të Pallatit të Kongreseve, më datë 7 nëntor.

Çmimet KULT vazhdojnë traditën e promovimit të artit dhe kulturës së vërtetë shqiptare, që prej vitit 2005, duke i dhënë një jehonë të denjë gjithë artistëve të mëdhenj dhe atyre të rinj.

Mbrëmja e datës 7 nëntor do të na njohë me emrat e fituesve në një Mbrëmje Gala me të ftuar speciale dhe surpriza që do të jenë pjesë e mbrëmjes kushtuar artistëve që kanë spikatur gjatë vitit 2014.

Në edicionin e 11 të Çmimeve KULT janë në garë 52 artistë, të cilët konkurrojnë në 13 fusha: Artisti Pamor i Vitit, Regjisori i Vitit, Aktori i Vitit, Aktorja e Vitit, Instrumentisti i Vitit, Interpretuesi Lirik i Vitit, Kënga e Vitit, Balerini i Vitit, Libri Artistik, Libri Studimor, Përkthimi i Vitit, Libri Publicistik i Vitit dhe Dokumentari i Vitit.

Edicioni i 11

E SHTUNË, 7 NËNTOR 2015 Mbrëmja Gala e artit dhe kulturës shqiptare ORA 19.30

Live në
rtsh

<p>Libri Esecistik</p> <p>Ben Blushi "Hëna e Shqipërisë"</p> <p>Besnik Mustafaj "Bishki i kometes"</p> <p>Besim Fusha "Pietro Marabbi, "Industria" që lodh përparësinë... spronë craigiane"</p> <p>Fatos Baxhaku dhe Klejdiana KAPO "Grua të përgjithshme historit prehistorike shqiptar në periudhën e Zogut"</p>	<p>Dokumentari i Vitit</p> <p>Anila Varfi "Dinastia Tedeschini"</p> <p>Fatos Baxhaku "Rringjalla pas errësirës"</p> <p>Donika Muçi "Marko Bocari, një mit për Europën"</p> <p>Mevlan Shanaj "Të fala nga Nôrek Luca"</p>	<p>Aktori i Vitit</p> <p>Alfred Trebicka "Ata hyjnë pa trokitur" (Burr)</p> <p>Robert Ndrenika "Djemtë gazmore" (Will Klark)</p> <p>Neritan Liçaj "Janja, Sotja, Masha e të tjerë" (Vanja)</p> <p>Sotirag Bratko "Kapitulli i dytë" (Xhorxhi)</p>
<p>Aktorja e Vitit</p> <p>Eva Alikaj "Hamlet maquia" (Orelia)</p> <p>Rozi Kostani "Ata hyjnë pa trokitur" (Gruaja)</p> <p>Olta Daku "Janja, Sotja, Masha e të tjerë" (Sotja)</p> <p>Zamira Kita "Kapitulli i dytë" (Xhen)</p>	<p>Regjia e Vitit</p> <p>Driada Dervishi "Janja, Sotja, Masha e të tjerë"</p> <p>Sesilia Plasari "Liri në Bremen"</p> <p>Kledi Kapexhiu "Shkëdhata me kapelo"</p> <p>Spiro Duni "Udhëtim i gjatë drejt natës"</p>	<p>Libri Artistik i Vitit</p> <p>Arrian Christian Kuyçku "Hume" roman</p> <p>Mira Meksi "Mallkimi i prifërshave të lirisë" roman</p> <p>Lazer Stani "Kohë për muze" tregime</p> <p>Virion Graçi "Sina e hijeve" roman</p>
<p>Përkthimi i Vitit</p> <p>Afrim Koçi "Montenji dhe 3 legjenda" Stefan Zweig</p> <p>Rudi Erebara "Mabi Dik" Herman Melville</p> <p>Ben Andoni "Këngët e zogëve të egër" Enes Karik</p> <p>Virgjil Muçi "Bir" Andrej Nikolaidis</p>	<p>Artisti Pamor i Vitit</p> <p>Adrian Çene "Manipulations" Ekspozitë personale</p> <p>Gazmend Leka "Icarus" Ekspozitë personale</p> <p>Enkelejd Zonja "Vizite në plage" Ekspozitë personale</p> <p>Jorgji Gjokopulli "Solo Exhibition" Ekspozitë personale</p>	<p>Libri Studimor</p> <p>Bardhyl Demiraj "Shqiptar dhe shqipe: histori populsh përmes dy emrave etnikë"</p> <p>Kristo Frashëri "Ahmet Zogu: vështrim historik"</p> <p>Belina Budini "Tri kohë të Shqipërisë në Time"</p> <p>Shaban Sinani "Shqiptaret dhe hebrenjtë: mbrojtja dhe shpëtimi"</p>
<p>Interpretuesi Lirik</p> <p>Armando Kilogjeri Mario Cavaradosi "Tosca"</p> <p>Ermonela Jaho Cio San "Madame Butterfly"</p> <p>Eva Golemi Floria Tosca "Tosca"</p> <p>Vikena Kamenica Dorabella "Così fan tutte"</p>	<p>Balerini i Vitit</p> <p>Brigel Gjoka "Hera e parë"</p> <p>Kledi Kadiu "Hera e parë"</p> <p>Enada Hoxha "Zhezë"</p> <p>Ledia Sulaj "Coppelia"</p>	<p>Kënga e Vitit</p> <p>Alban Skënderaj "Je ti"</p> <p>Rosela Gjylbegu "Rri me mua"</p> <p>Besa "Ti je festa ime"</p> <p>Kejsi Tola "Izberg"</p>
<p>Instrumentisti e Vitit</p> <p>Jonela Golemi Flaut</p> <p>Redi Llupa Piano</p> <p>Petrit Çeku Kitare</p> <p>Tedi Papavrami Violinë</p>	<p align="center">VOTONI ARTISTIN TUAJ TË PREFERUAR nëpërmjet internetit në adresën: www.akademiakult.com</p> <p align="center">Mundësues të aktivitetit:</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around;">        </div>	

Shkëndija elektrike shkakton zjarr në ambientet e laboratorit



EKSPERTIMET

Në laboratorin kriminalistik ekspertohen të gjitha provat, si armë, shenja gjishtash e të tjera, që oficerët e policisë gjyqësore sekuestrojnë në një vendngjarje.

Lideri i opozitës Lulzim Basha: Zjarri i qëllimshëm, për djegien e drogës

Një shkëndijë elektrike në godinën e Laboratorit Qendror të Kriminalistikës që gjendet tek Garda e Republikës ka djegur telat që furnizojnë me ndriçim këtë ndërtesë. Sipas një njoftimi zyrtar të Policisë së Shtetit, si pasojë e kësaj mase elektrike është djegur njëri prej

neonëve të ndriçimit në një nga shesh pushimet e katit të dytë të laboratorit kriminalistik. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 02:15 minuta të mëngjesit të së enjtes dhe policia sqaron se asnjë nga laboratorët nuk është dëmtuar nga zjarri. "Përveç djegies së neonit dhe telave që furnizojnë me energji neonin në shesh pushim nuk ka asnjë dëmtim tjetër. Asnjë prej sallave të laboratorit nuk është prekur nga zjarri", thuhet në njoftimin e policisë. Por i pari që dha lajmin për këtë incident në Laboratorin Shkencor të Policisë ishte lideri i opozitës Lulzim Basha, i cili hodhi dyshime për një zjarr të qëllimshëm për të shkatërruar sipas tij, provat në lidhje me drogën e konfiskuar nga policia në disa operacione të

fundit. Përmes një statusi në rrjetin social "Facebook", kryedemokrati Basha shkruan se është njoftuar nga oficerët e policisë se zjarri ishte i qëllimshëm, madje ai akuzon se policia po tenton ta fshehtë këtë ngjarje. "Zjarr në Laboratorin Shkencor të Policisë! Raportohet nga oficerët të policisë se zjarri është i qëllimshëm dhe ka pasur objektiv shkatërrimin e provave në lidhje me drogën e konfiskuar në disa operacione të fundit. Po bëhen përpjekje për ta fshehur këtë akt kriminal"- shkruan në "Facebook" kreu i Partisë Demokratike Lulzim Basha. Në laboratorin kriminalistik analizohen të gjitha provat, si armë, shenja gjishtash e të tjera, që oficerët e policisë gjyqësore sekuestrojnë në një vendngjarje.

LAJME shkurt

Tentoi të vidhte kishën e "Shën Dhimitrit", kapet

Një person është vënë në pranga në Burrel, pasi tentoi të vidhte disa sende me vlerë në një kishë të qytetit. Sipas burimeve nga policia, në pranga është vënë 43 vjeçari Bashkim Kriko, nga fshati Plan i Bardhë. Efektivët e policisë kanë bërë me dije se 43 vjeçari u kap në flagrancë duke vjedhur disa sende në kishën e "Shën-Dhimitrit", që ndodhet në fshatin Qenuurjo-Finiq. Sipas policisë, sendet e vjedhura nga Kriko ishin me vlerë 20 mijë lekë të reja.



Pranga serbit në Muriqan, u kap me marijuanë

Një 36 vjeçar serb është arrestuar nga policia kufitare Shkodër për posedim të lëndëve narkotike. Mësohet se në pranga ka rënë 36 vjeçari Aleksandër Maslovara, banues në Kragujevcu, Serbi. Sipas policisë, gjatë kontrollit në automjetin e tij tip "Alfa 159" me targa KG 107 FA, në vijën e dytë të kufirit, janë gjetur 38 gr marijuanë. Policia bën me dije se në pjesën e prapakolpit është gjetur një letër e bardhë dhe në brendësi të saj kishte drogën.

Kapen shqiptarët trafikonin klandestinë

Policia franceze dhe ajo britanike kanë shkatërruar një grup kriminal që merrej me trafikun e qënieve njerëzore. Në pranga kanë përfunduar pesë shqiptarë, të cilët bashkëpunonin me një peshkatar francez dhe dy shtetas vietnamez, për të trafikuar emigrantët nga tuneli "Channel", për në Britani të Madhe. Aksioni i policisë franceze u zhvillua në qytetin Lille. Peshkatar, i cili u kap në flagrancë, merrte 1000 euro për çdo udhëtar. Sipas hetimeve, rrjeti drejtohej nga shqiptarët.

Frroku: Të shkoj në Kuvend si deputetët e "Agimit të Artë"

Deputetit të akuzuar për vrasje, i ndërpritet rroga

ELTON QYNO
TIRANË

Deputeti Mark Frroku që mbahet në burg për një vrasje në Belgjikë në 1999 kërkon me çdo kusht të jetë pjesë e zhvillimeve parlamentare. Ai ka bërë një paralelizëm me një precedent në Greqi ku disa nga deputetët e "Agimit të Artë", edhe pse janë arrestuar nga prokuroria për një sërë akuzash, nuk i ndalohej të mos jenë pjesë e zhvillimeve të parlamentit. Sipas Frrokut, edhe prokuroria shqiptare duhet të bëjë të njëjtën gjë si ajo greke që lejon deputetët të marrin pjesë në mbledhjet e parlamentit. Mirëpo pavarësisht këtyre pretendimeve, Prokuroria e Përgjithshme shprehet se nuk mund të marrë shembuj nga prokurori të tjera, por do zbatojnë vetëm legjislacionin shqiptar. Nga ana tjetër deputeti Mark Frroku ka ironizuar në ambientet e Gjykatës së Lartë, duke deklaruar se: "...aman kjo politika, edhe lekët na i mori dhe në burg na futi..."


S'IA JAPIN RROGËN

Prej 28 marsit të këtij viti administrata e Kuvendit i ka ndërprerë rrogën e deputetit, Mark Frroku i cili ndodhet në masën e sigurisë të "arrestit me burg" për akuzat e

Deputeti Prenga mbetet në burg pas tërheqjes së avokatëve



Prova e fundit që prokurorët Altin Binaj dhe Arben Kraja paraqitën në Gjykatën e Lartë, ka bërë që avokati Baftjar Rusi të tërhiqet nga kërkesa për lirinë e deputetit të Lezhës Armando Prenga, të arrestuar më 5 shtator pas konfliktit me armë me familjen Cali për Lagunën e Patokut. Në një seancë të mbajtur këtë të enjte, me praninë edhe të Prengës, trupa gjyqësore e kryesuar nga Mirela Fana vendosi të mos ndryshojë masën e sigurisë "arrest me burg", duke e lënë në burg deputetin e përjashtuar nga grupi parlamentar i PS-së.



Deputeti Mark Frroku

drejtësisë belge për vrasje të Aleksandër Kurtit. Ishte vetë deputeti kristian demokrat Mark Frroku, i cili shfaqti pakënaqësinë e tij ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Lartë këtë të enjte. Ndërprerjen e pagës, Frroku nuk e ka përjetuar mirë ku në një moment sinjeriteti dhe me batutë ndaj gazetarëve kur trupi gjyqësor ishte tërhequr për vendim u shpreh: "...aman kjo politika, edhe lekët na i mori dhe në burg na futi...". Avokati Saimir Visha tha se ndërprerja e rrogës së deputetit nga ana e Parlamentit është një veprim antikushetues, pasi Mark Frroku nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë, por është person nën hetim. Avokati Visha tha se do të interesohet përsëri është

AVOKATI

Avokati Saimir Visha tha se ndërprerja e rrogës së deputetit nga ana e Parlamentit është një veprim antikushetues, pasi Mark Frroku nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë, por është person nën hetim.

Precedenti

Sipas Frrokut, dhe prokuroria shqiptare duhet të bëjë të njëjtën gjë si ajo Greke që lejon deputetët të marrin pjesë në parlamentit.

marrë ky vendim, vetëm dy ditë pas arrestimit të Frrokut.

ARRESTIMI ME DOSHIN

Deputeti Mark Frroku u arrestua më 26 mars të këtij viti së bashku me Tom Doshin me akuzën se inskenuan historinë e atentatit që do i bëhej Doshit me urdhër të Ilir Metës. Por tashmë ai ndodhet në qeli për akuzat që vijnë nga drejtësia belge se në vitin 1999 ka vrarë shqiptarin Aleksandër Kurti në Bruksel. Në Gjykatën e Lartë u mbajt seanca për të shqyrtuar kërkesën e deputetit Frroku për të lënë qelinë ditën e enjte dhe të jetë i pranishëm në seancën plenare. Trupa gjyqësore vendosi të shprehet me një vendim për këtë kërkesë ditën e hënë.

Roshi në prokurori, do pyetet për 600 kontratat

Kryebashkiaku i Kavajës njeriu që ka firmosur qindra kontrata për transferimin e banimit të personave

ELTON QYNO
TIRANE

Kryebashkiaku i Kavajës Elvis Roshi do thirret në prokurorinë e këtij qyteti, lidhur me firmosjen e qindrave kontratave, dokumenta këto që i kanë dhënë mundësi shumë personave të zhvendosin banimin e tyre nga qytete e fshatra të ndryshme në Kavajë. Mësohet se Roshi është personi që ka firmosur pjesën më të madhe të këtyre kontratave dhe kjo sipas burimeve të prokurorisë është faktuar edhe me ekspertizë të firmës së hedhur në dokumenta. Nisur nga kjo situatë është parë e nevojshme pyetja e kryebashkiakut dhe për pasojë pritet që në vijim ai të japë dhëmi rreth kësaj çështje, e cila para zgjedhjeve lokale krijoi një debat të ashpër mes dy forcave politike.

PYETEN MBI 100 PERSONA

Pesë muaj nga nisja e hetimeve në prokurorinë e Kavajës, janë pyetur plot 100 persona. Ata kanë dëshmuar se kanë gjetur strehim në disa banesa të braktitura, duke pretenduar se ardhja në qytet mund t'i krijonte një jetë më të mirë, duke filluar me mundësinë e një pune, apo një shërbim më të mirë spitalor. Hetimi ka zbuluar se pjesa më e madhe e këtyre kontratave është firmosur nga kryebashkiaku Elvis Roshi, i cili shumë shpejt do thirret në cilësinë e personit që ka dijeni mbi

KËRKESAT

Lista, me 2800 persona, u kërkua që të hiqet nga votimi

Në momentin që është bërë kallëzimi dhe ka nisur hetimi, 2800 personat e regjistruar fiktivisht ishin të përfshirë në listat e votuesve të qytetit Durrës dhe për këtë arsye, Prokuroria e Durrësit i ka dërguar njoftim Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për t'i hequr nga lista e votuesve, si edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për t'i hequr nga lista e banorëve të qytetit Durrës. Gjithashtu, në vijim të veprimeve procedurale, Prokuroria e Durrësit ka kërkuar në gjykatë sekuestrimin e listës së regjistrit të këtyre personave në Regjistrin e Gjendjes Civile të Bashkisë Durrës. Kërkesa për sekuestrimin e kësaj liste është pranuar sërish nga gjykata.

çështjen. Burimet pranë organit të akuzës thanë se bëhet fjalë për rreth 600 persona të transferuar, dhe se pjesa më e madhe është vendosur në ambientet e disa go-

dinave të braktitura në qytetin e Kavajës. Aktualisht çështja po vijon ndërkohë për çdo rast është kërkuar kryerja e ekspertimit të firmave të hedhura në dokumenta. Për këtë çështje prokuroria e Kavajës është duke bashkëpunuar edhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke kërkuar materiale të ndryshme. Në zgjedhjet lokale të qershorit 2015, në Kavajë fitues u shpall kandidati i Partisë Socialiste Elvis Roshi.

DOSJA E DURRËSIT

Një tjetër hetim i ngjashëm me atë të Kavajës është duke u zhvilluar dhe në prokurorinë e Durrësit, ku mendohet se në gjendjen civile të kësaj bashkie janë regjistruar fiktivisht plot 2800 persona, që rezultojnë votues artificial. Për këtë skemë, prokuroria e Durrësit ka pezulluar nga ushtrimi i aktivitetit noteren Ines Aklesi e cila ka noterizuar më tepër se 100 kontrata qërroje shtëpie. Masa e pezullimit nga detyra është dhënë dhe për drejtorin e ndërmarjes Komunale në zonën e Plazhit në Durrës, shtetasin Alfred Dhuli, i cili dyshohet se ka konsumuar veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Falsifikimit të dokumentave". Momentalisht hetimi është në vazhdim dhe se mendohet se në këtë skemë janë të përfshirë dhe punonjës të tjerë të gjendjes civile. Ndërkohë që për të hedhur dritë mbi këtë ngjarje, prokuroria e Durrësit ka shpërndarë 600 fletë-tirje, me qëllim marrjen në pyetje të personave që mendohet se janë të implikuar në këtë skemë.



Elvis Roshi




Vangjush Dako

BASHKËPUNIMI

Aktualisht çështja po vijon ndërkohë për çdo rast është kërkuar kryerja e ekspertimit të firmave të hedhura në dokumenta. Për këtë çështje prokuroria e Kavajës është duke bashkëpunuar edhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke kërkuar materiale të ndryshme.

LAJME SHKURT




Sherr mes dy shoqëruesve të Nishanit, largohen nga eksorta e tij

Një konflikt midis Krenar Ahmetit, shefit të sigurisë së Presidentit dhe vartësit të tij, shoqëruesit personal të Bujar Nishanit, Hazbi Pëllumbi, i ka kushtuar largimin nga puna dy efektivëve të gardës. Incidenti ka ndodhur të hënën në ambientet e Presidencës, pak çaste pasi eskorta ka sjellë në zyrë Nishanin. Konflikti midis dy gardistëve ishte i përsëritur, e për këtë shkak mësohet se me pëlqimin e Presidentit është vendosur zëvendësimi i dy shoqëruesve dhe pezullimi i Ahmetit dhe Pëllumbit nga detyra. Të dy do të mësojnë të premtën vendim e gardës nëse do të përjashtohen apo jo nga radhët e saj.


I dënuari me 25 vjet burg, punonte si bari për t'u fshehur

Një 64 vjeçar, i dënuar me 25 vite burg kishte zgjedhur të punonte si bari në Lazarat për t'i shpëtuar policisë. Megjithatë, blutë e Gjirokastrës kanë arritur të zbulojnë maskimin e tij dhe e kanë vënë në pranga. Mësohet se i arrestuari është 64 vjeçari Lavdimir Ajçe. Ai ka lindur në fshatit Bitincë të Devollit, ku rezultoi edhe banues. Ajçe është dënuar me 25 vjet burg për veprat penale: "Vrasje me dashje", "Vrasje me dashje mbetur në tentativë" dhe "Armbajtje pa leje". 64 vjeçari u arrestua dje rreth orës 15:00 në vendin e quajtur Peciak.



Fier-Vlorë, tre automjete në aksident, një i vdekur

Një tjetër aksident me pasojë vdekjen e një personi, u regjistrua mbrëmjen e djeshme në aksin Fier-Vlorë. Mësohet se një automjet tip "Kia" me targë AA 613 LM, ka goditur një mjet tip triçikël, me të cilin udhëtonte një banor i komunitetit rom, i cili ka mbetur vdekur në vend. Nga devijimi pas përplasjes me triçiklin, "Kia" ka përpjasur edhe një tjetër mjet tip "Volvo", me targa FR 1420 D. Identiteti i të përfshirëve në aksident nuk është bërë me dije, përfshirë edhe ai i viktimës. Policia po heton për zbardhjen e detajeve të ngjarjes.




Ekstradohet drejt Italisë bos i grupit të kokainës

Autoritetet shqiptare kanë ekstraduar drejt Italisë Edmond Tepshin, i akuzuar si drejtues i një grupi për trafikimin e kokainës nga Shqipëria në Itali. 52 vjeçari Edmond Tepshin u arrestua për llogari të drejtësisë italiane në fillim të muajit korrik në Durrës. Bashkë me të u arrestua dhe djali i tij 25 vjeçari Guido, dy vëllezërit e Edmondit, Artur dhe Luan Tepsh, respektivisht 49 dhe 46 vjeç, Kastriot Dyrmyshi 32 vjeç dhe Laert Peneqexhi. Guido Tepshi është futbollist i Kastriotit dhe ish pjesëtar i ekipeve zinxhir të 19 dhe 21 vjeçarëve të Kombëtares.

Tiranë, përfshihen nga zjarr 3 banesa në rrugën "Hoxha Tahsim"

3 banesa janë përfshirë nga flakët në rrugën "Hoxha Tahsim" në kryeqytet pasditen e djeshme. Mendohet se fillimisht zjarr ka rënë në njërin nga banesat, e cila ishte në pronësi të Mustafa Jahjes dhe më pas ka kaluar tek dy të tjerat. Nga kjo ngjarje, nuk është raportuar për të lënduar, por vetëm për dëme material. Fatmirësisht forcat zjarrfikëse kanë bërë të mundur shuarjen e flakëve pa u përhapur më tej në banesa të tjera, ndërsa po punohet për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes.



Shkodër, humb jetën një 19 vjeçar, plagoset një tjetër

Një aksident me pasojë vdekjen e një 19 vjeçari dhe plagosjen e një tjetër personi ka ndodhur pasditen e djeshme në Shkodër. Mësohet se ngjarja ka ndodhur në aksin Shkodër-Oblikë rreth orës 17:20. Viktima, i identifikuar si shtetasi Ilir Dahati, duke drejtuar mjetin motoçikletë me targë AB684, nga Oblika për në Shkodër, është përplasur me një karrocë në vendin e quajtur "Shtëpia e Malësorit". Si pasojë e këtij aksidenti, 19 vjeçari ka ndërruar jetë në spital, ndërsa ka mbetur i plagosur edhe një person tjetër, i cili ishte duke udhëtuar me viktimitin, në motor.

ADMIRINA PEÇI

Në fund të vitit 1950 dhe në fillim të vitit 1951, Komiteti Qëndror i PPSH-së po kalonte në filtër të gjithë artistët me të shkuar "të dyshimtë", të angazhuar kryesisht në Filarmoninë e Shtetit. Dokumentet që po botojmë (pjesëne parë të tyre dhe rastin e sopranos Marie Kraja e prezantuar një ditë më parë), zbardhin dhe shpjegojnë historitë profesionale të shumë artistëve të operas dhe baletit në vitet e regjimit komunist. Në listën që është hartuar nga drejtoritë e sigurimit të shtetit sipas porosisë së Komitetit të Artit dhe Kulturës, renditen emrat: Marie Ndue Kraja, Lek Kiço Tasi,

Fatbardha Ismail Tatxati, Zef Gruda, Tonin Harapi, Haki Bejleri, Tonin Filip Guraziu, Aleko Lame Kareco, Mateo Pjetër Guralumi, Nik Pjetër Guralumi, Benjamin Zef Guraziu, Agron Abdyl Aliaj, Gëzim Ali Kaceli, Flora Masar Kallanxhiu, Alma Neki Radovicka, Vilhelm Sulo Konjari, Minever Kallajxhi, Evlloqija Dh. Mina, Paulina Dh. Mina, Paulina Dh. Mina, Elisabeta Romelo Sojli, Lefter Besho, Ulki Haki Bel, Drita Xhemal Beqiri, Mirasillova V. Saraçi, Paulin Zef Zekuj, Pjetër Gjoka. Pjesa dërrmuese e tyre ishin artistë virtuozë, me përgatitje nga shkollat perëndimore, dhe mëkati për të cilin gjykoreshin nuk

lidhej shumë me ta, aq sa lidhej me bigrafinë e familjeve të tyre. Kjo periudhë, kur këta artistë u analizuan në imtësi ndikoi shumë edhe në të ardhmen artistike të pjesës më të madhe të tyre. Pas kësaj periudhe një pjesë e tyre përfunduan në burg, dhe ju deshën vite të rehabilitohen e të integroheshin në jetën skenike të vendit.

Më poshtë sjellim dokumentin e plotë ku analizohet sicili prej tyre, ndërsa nesër, në vijim të kësaj teme do të sjellim dokumentin e firmosur nga Tuk Jakova, ku jepen të gjithë udhëzimet se si dhe ku duheshin bërë spastrimet.

SIGURIMI:

JA LISTA E 28 ARTISTËVE TË OPERAS QË DUHEN SPASTRUAR

Lista kryeson me Marije Krajen. Më tej renditen Lek Tasi, Pjetër Gjoka, Zef Gruda, Tonin Harapi, Haki Bejleri, Tonin Guraziu, Aleko Kareco, Mateo dhe Nik Guralumi, Agron Aliaj, Gëzim Kaceli, Flora Kallanxhiu, Alma Radovicka, Vilhelm Konjari, Minever Kallajxhi, etj...

RELACION

Në lidhje me shkresën tuaj nr. 493/10, dt. 11.10.1950 tepër rezervat ky Komitet duke studiuar përbërjen e kuadrit të tij dhe duke analizuar mirë të kaluarën si dhe të tashmen të secilit dhe natyrën e sektorit të punës ku punojnë, nxjerr se ka kuadro që paraqesin mungesë garancie për të kaluarën e tyre ose për kondita familjare dhe për këtë mendojmë që t'i pushojmë nga detyra, porse zëvendësimi i tyre tani për tani nuk mund të bëhet përderisa të përgatiten kuadrot tona artistike të reja, të cilat kërkojnë një përgatitje prej 6-7 vjetësh brenda shtetit dhe jashtë shtetit në konservatorët e lartë.

Përveç kësaj kategorie, për një përbërje më të mirë të korit mbasi nuk paraqesin ndonjë punë armiqësore për t'u pushuar në kërkime që këta njerëz që janë të kompromentuar nga rrethi t'i largojmë nga grupet tona qendrore, megjë grupet tona dalin jashtë dhe t'i kalojmë në sektorët e tjerë duke i zëvendësuar me elementë që kanë kondita të mira.

Kemi disa anëtarë të baletit që familjet e tyre kanë pasur aktivitet kundër Luftës sonë NÇL. Disa prej tyre sot kanë babanë në burg e disa të afërt të arratisur dhe këta janë në një numër prej 5 vetash, gabim i cili është bërë që në fillim nga ana jonë në marrjen e tyre. Për këta mendojmë mbasi janë të vegjël në moshë, po të bëhet një punë e shëndoshe edukative me këta, kanë mundësi përmirësimi dhe të shkëputen dhe t'i bëjmë për pushtetin.

Këtu poshtë po ju përshkruajmë elementët që mendojmë të pushohen, elementët që mendojmë të largojmë me zëvendësim dhe

elementët që me punë edukative do të bëhen të vlefshëm:

1) Marie Ndue Kraja, artiste lirike, pushohet për mungesë garancie për këto arsye: gjatë okupacionit gjithë familja e saj ka bashkëpunuar me armikun, e kanë urreyer luftën e popullit dhe kanë propaganduar kundër saj. Babai i saj ka qenë bashkëpunëtor i nazistëve, vëllai ka qenë spiker në stacionin nazist në Gjermani. Në fund të vitit 1944 e gjithë familja arratiset në Austri. Qëndrimi i saj gjatë okupacionit ka qenë indiferent, nuk e ka simpatizuar lëvizjen nacionalçlirimtare, ka punuar në Radio Tirana dhe ka dhënë koncert në Firence, në Bari. Qëndrimi i sotëm është indiferent, nuk ka veprimtari armiqësore. Punën që i është ngarkuar e ka kryer, ka realizuar planin.

Zëvendësimi i saj mund të bëhet për 7 vjet.

2) Lek Kiço Tasi, violonçelist në orkestër, të pushohet për mungesë garancie. Gjatë Luftës NÇL ka qenë i vogël, qëndrimi i familjes ka qenë indiferent. Në vitin 1941 kthehen familjarisht nga Greqia në Shqipëri, mbasi i ati i tij ka qenë i arratisur politik si kundërshtar i Zogut. Sot ka në burg babanë dhe vëllanë si elementë antipushtet. Qëndrimi i tij paraqitet indiferent, nuk ka veprimtari armiqësore. Rrethi i tij shoqëror nuk është i mirë, shoqërohet me njerëz të kategorisë së tij të pakënaqur dhe që kanë të afërmit e tyre në burg.

Zëvendësohet për 4-5 vjet.

3) Fatbardha Ismail Tatxati, armonium në orkestrinë. Ka mungesë garancie. Ka qenë influencuar nga rrethi i saj familjar dhe lëvizjen nacionalçlirimtare e ka urreyer. Aktivitet të dukshëm nuk ka pasur. Është e prekur nga

pushteti për arsye se i është pushkatuar i ati si kriminel luftë. Në vitin 1939 janë kthyer nga Greqia në Shqipëri familjarisht mbasi ishin të arratisur politikë si kundërshtarë të Zogut. Gjithë rrethi familjar ka qenë me Ballin, dhe babai i saj eksponent me gradën kolonel. Në fillim kriminelët që u pushkatuan nga pushteti ynë i quante "dëshmorë". Qëndrimi i sotëm është indiferent, për punën është e mobilizuar, është e disiplinuar dhe e sjellshme. Në punë nuk ka rreth shoqëror, shoqërohet vetëm me pjesëtarët e familjes së saj. Zotëron armonium shumë mirë.

Zëvendësohet me një pianiste të mirë për 4 vjet.

4) Zef Gruda, klarinetë, orkestrinë. Nga Shkodra, është rritur jetim të një dajë i tij, i cili punonte si kishtar i kishës françeskane. Ka qenë i lidhur me kishën. Daja i tij gjatë okupacionit u bë oficer milicie. Luftën nuk e ka parë me sy të mirë, ashtu dhe luftën e Bashkimit Sovjetik. Qëndri i vinte keq që po humbiste Gjermania dhe Italia fashiste. Gjatë okupacionit nuk ka zhvilluar aktivitet armiqësor, ka ushtruar kumarin dhe alkoolin vazhdimisht. Kur doli banda në mal në tetor 1944, ka dalë dhe ky. Në punën ku është, ka qenë vazhdimisht i pakënaqur, i padisiplinuar dhe prish punë më tepër se sa ndreq. Nuk ka shenja të punës armiqësore të organizuar, por vetë puna që ai bën vërteton se ai nuk e do pushtetin tonë.


5) Tonin Harapi, pianist baleti. Nuk ka garanci. Të kaluarën nuk e ka të mirë, e ka urreyer Luftën NÇL dhe ka propaganduar kundër saj. Ka qenë i lidhur me fenë, me

politikën françeskane dhe rrethi familjar të njëjtin qëndrim ka pasur. Djemtë e xaxhaxit të tij për aktivitet politik ndodhen njëri i arratisur në Itali dhe tjetri në burg. Qëndrimi i tij i sotëm është indiferent.

Zëvendësohet për 3 vjet.

6) Nehat Osman Dylçe, arkivist protokoll në NSHKSH. Të pushohet për të kaluarën e keqe. Ka qenë roje finance prej vitit 1941 deri më 1943 dhe bashkëpunëtor i SIMI-t në Gjirokastrë. Ka ndjekur shokët komunistë të Gjirokastrës. Në karakteristikën e bërë nga Radio Tirana thuhet se në Gjirokastrë ka kapur një shok ilegal dhe shoku i shpëtoi nga duart dhe këtj i mbeti pallto e shokut në dorë. Kur është pyetur, është justifikuar duke thënë se "kujtova se do më vriste, për këtë u frikësova dhe e kapa". Në mbremjen që u dha me rastin e Vitit të Ri 1951 nga ky komitet, shoku Bedri Spahiu që erdhi për një vizitë të





Peshkopi dhe Strugë. Në prill 1942 u gradua toger. Ka qëndruar në këtë detyrë deri në gusht 1944.

Në autobiografinë e tij thotë se e ka simpatizuar Luftën NCL dhe ka u dhënë ndihmë vëllezërve Agolli në Strugë. Në plotësimin e fletës së biografisë ka mohuar qenien e tij si anëtar i partisë fashiste.

Qëndrimi i sotshëm është indiferent. Është i mobilizuar për punën që i ngarkohet. Nuk i është konstatuar ndonjë qëndrim armiqësor kundrejt pushtetit.

Zëvendësohet me kohë.

2. Tonin Filip Guraziu, pianist. Shtresë e lartë tregtarësh florinjsh. Vjen prej familjeje borgjeze. Ka kryer studimet në Itali, si shkollën fillore, të mesmen dhe konservatorin e lartë. Ka qëndruar familjarisht për 20 vjet. Nuk ka konsideratë për këngët popullore. I pëlqejnë këngët klasike. Zëvendësohet në një kohë të ardhme me elementë të rinj që do të dalin nga konservatorët.

3. Aleko Lame Kareco, fizikmonicist. Rrjedh prej shtrese borgjeze, babai i tij ka qenë deputet i regjimit të Zogut dhe kundër lëvizjes nacionalçlirimtare dhe pushtetit dhe si i tillë ndodhet në burg. Aleko është ndaluar nga Ministria e Brendshme për të dalë në Jugosllavi m e

Brigadën Speciale për ndërtimin e hekurudhës, ndërsa tani ka qenë në demokracitë popullore me baletin.

Në lëvizjen nacionalçlirimtare nuk ka marrë pjesë. Sot tregohet aktiv në punë dhe veprimtari armiqësore nuk ka. Mendojmë që të largohet në një sektor tjetër dhe mund të zëvendësohet për 5 vjet.

4. Mateo Pjetër Guralumi, violonçelist. Gjatë Luftës NCL ka qenë i vogël, mbas çlirimit ka vazhduar Politeknikumin dhe aty është përjashtuar nga organizata e rinisë me rastin e Unifikimit. Këtë e ka thënë në autobiografinë e tij që "jam përjashtuar për mungesë aktiviteti karshi organizatës së rinisë". Gjithashtu edhe vëllai i tij përjashtohet nga rinia në Liceun e shtetit. Njëkohësisht pushohet nga puna në Radio Tirana.

Mendojmë që të edukohet dhe të zëvendësohet me kohë.

4. Nik Pjetër Guralumi, violinist. Rrjedh prej një origjine zanatçinsh individualë. Nuk ka marrë pjesë në Luftën NCL. Ka kryer Liceun e shtetit në vitin 1946 dhe një vit Institutin Pedagogjik. Qëndrimi i tij karshi organizatës së rinisë nuk ka qenë i mirë dhe për këtë është përjashtuar nga rinia kur ka qenë në Liceun Artistik dhe njëkohësisht është pushuar nga puna në Radio Tirana si njeri kundër pushtetit. Nuk e ka treguar në autobiografinë e tij.

Mendojmë që të edukohet dhe të zëvendësohet.

5. Beniamin Zef Guraziu, violinist. Vjen prej shtrese të lartë. Babai i tij merrej me tregtinë e artit. Ka bërë një vit universitet për mjekësi në Itali, në vitin 1942-1943. Gjatë Luftës NCL nuk ka dhënë asgjë. Qëndrimi i sotshëm është indiferent. Qëndrimi i tij në punë është i mirë.

Mendojmë që të bëhet i mirë me një punë edukative.

Shënim: - Për të sipërmit ky komitet mendon meqë këta vijnë nga familje borgjeze dhe nuk janë për reformat tona, mendojmë që të zëvendësohen me kohë dhe të kalojnë në

sektorë të tjerë.

1. Agron Abdyl Aliaj, anëtar baleti, sot në Bashkimin Sovjetik. Gjatë lëvizjes nacionalçlirimtare ka qenë i vogël. Babai i tij ka qenë bashkëpunëtor i SIMI-t në Delvinë. Njihet me emrin Abdyl Borshi. Në vitin 1942 shpërngulen familjarisht nga Delvina për në Tiranë. Mbas çlirimit të Shqipërisë kanë ndërruar mbiemrin, mbasi e kanë pasur "Beu" dhe mbanin emrin e katundit Borsh. Gjithë rrethi i tij familjar ka qenë me Ballin, vëllai i nënës ka qenë eksponent i Ballit dhe sot ndodhet i arratisur në Itali e Amerikë i quajtur Xhemil Leka, gjithashtu edhe një djalë i dajës së tij. Sot rrethi familjar i tij nuk qëndron mirë. Janë prekur nga pushteti i sotshëm. Ky është një nga anëtarët e parë të Baletit më të dalluar.

Mendojmë që me një punë edukative të bëhet i mirë.

2. Gëzim Ali Kaceli, anëtar baleti. Vjen prej shtrese të pasur qytetare. Gjatë Luftës NCL ka qenë i vogël. Qëndrimi i familjes së tij ka qenë indiferent, nuk ka zhvilluar ndonjë aktivitet. Mbas çlirimit vëllai i tij arratiset (në dhjetor 1948) dhe me sa dihet është në Jugosllavi. Babai i tij është i internuar për shkakun e të birit. Gjithashtu edhe ky ka qenë për 7-8 muaj, por është liruar.

Mendojmë që me një punë edukative ta shkëpusim dhe të bëhet i mirë.

3. Flora Masar Kallanxhiu, anëtare baleti nga Gjirokstra. Shtresë e mesme qytetare. Familja e saj ka qenë e lidhur me Ballin dhe lëvizjen nacionalçlirimtare e ka uryer. Sot babai i saj ndodhet në burg. Ka pasion për balet dhe e kryen më së miri këtë detyrë.

Mendojmë që të bëhet e mirë me një punë edukative dhe ta shkëpusim nga influenca e rrethit familjar.

4. Alma Nekë Radovicka, anëtare baleti prej një familjeje të mesme qytetare. Gjatë luftës nuk ka dhënë asgjë për arsye moshe. Mbas çlirimit ka hyrë në organizatën e pionierit dhe bënte pjesë si balerinë. Babai i saj ka qenë në burg si element antipushtet dhe ka vdekur në burg. Në autobiografinë e saj thotë se "mbas kthesës së Partisë, babai i saj ka fituar pajafësinë".

Mendojmë që të edukohet dhe do të bëhet e mirë.

5. Vilhelm Sulo Konjari, anëtar baleti nga Gjirokstra. Rrjedh nga shtresë e mesme qytetare. Megjithëse në moshë të vogël, në Luftën NCL ka ndihmuar duke marrë pjesë në Ushtrinë NCL prej vitit (në fund) 1943 deri në dhjetor 1944. Qëndrimi i familjes gjatë luftës ka qenë indiferent. Mbas çlirimit babai i tij ka dalë në procesin e grupit të deputetëve dhe është dënuar me burgim. Sot është falur dhe ka dalë nga burgu. Kur ka dalë trupa e baletit jashtë shtetit në gusht 1950, ky është ndaluar nga Ministria e Brendshme dhe e kanë zbritur nga vapori.

Mendojmë që me një punë edukative të bëhet i mirë.

Shënim: - Ky komitet mendon, mbasi janë të vegjël në moshë, me një punë edukative do të bëhen njerëz të vlefshëm.

Lista e elementëve të korit dhe të Teatrit që ky komitet mendon që t'i ketë në planin e tij për të bërë një punë edukative me ta dhe disa do të jenë në plan për t'i zëvendësuar mbasi janë të kompromentuar nga rrethi i tyre, porse kanë disa kondita të mira, si p.sh., Drita Xhemal Beqiri "Sojli" koriste; qëndrimi i familjes së saj gjatë Luftës NCL ka qenë shumë i mirë, kanë qenë të lidhur me lëvizjen dhe babai i saj është dëshmor i Luftës NCL, vëllai i saj është oficer, vetë kjo ka mbajtur qëndrim të mirë gjatë luftës dhe ka ndihmuar duke shpërndarë trakte etj. Rrethi ku jeton kjo, d.m.th. i burrit të saj nuk është i mirë, është e knata e Kujtim Beqiri i çekzukturuar nga pushteti si sabotator i Malliqit.

- 1) Minever Kallajxhi koriste
- 2) Evloqija Dh. Mina
- 3) Paulina Dh. Mina
- 4) Elisabeta Romelja Sojli
- 5) Lefter Besho
- 6) Ulki Haki Beli
- 7) Drita Xhemal Beqiri
- 8) Mirallosva V. Saraçi
- 9) Paulin Zef Zekuj
- 10) Keti Vasil Avrami llogaritare NSHKSH
- 11) Pjetër Gjoka
- Filarmoni

mbrëmje, duke parë Nihat Osman Dylçen që po kërcënte, i thotë shokut Foto Stamo: "ky njeri nuk na ka lënë rehat në Gjirokastër duke na gjurmuar, ka qenë shumë i keq". Kjo vërteton veprimtarinë e tij si spiun i SIMI-t.

Mbas kapitullimit të Italisë ka qëndruar indiferent. Ka marrë pjesë në Ushtrinë NCL në tetor 1944. Qëndrimi i tij i sotëm – indiferent.

Zëvendësohet menjëherë.

7) Haki Bejleri, violinist. Qëndrimi i familjes së tij gjatë Luftës NCL nuk ka qenë i mirë, kanë qenë aktivistë të Ballit dhe kanë marrë pjesë në operacione të ndryshme të kryera kundër partizanëve në bashkëpunim me gjermanët. Për aktivitet kundër lëvizjes nacionalçlirimtare janë pushkatuar nga for-

cat tona. Ky s'ka pasur veprimtari. Zëvendësohet për 4-5 vjet.

SHËNIM: Për këta ky komitet nuk ka fakte për veprimtari armiqësore, por për arsye të familjarëve të tyre që janë të arratisur, të pushkatuar, të burgosur, paraqesin mungesë garancie. Mendojmë që të pushohen porse zëvendësimi nuk mund të bëhet tani, veçse kur të përgatiten kuadrot tona artistike.

1. Haki Bajram Pepa, shef i logarisë në NSHKSH, nga Dibra e Madhe. Ka kryer shkollën ushtarake në Napoli (Itali) prej vitit 1935 deri më 1937. Prej vitit 1938 deri më 1940 vazhdoi studimet në Akademinë Ushtarake të Rojës së Financës në Romë dhe në tetor të vitit 1940 u emërua me shërbim nëntogor i Rojës së Financës në qytetet Pukë, Kukës, Tiranë, Korçë, Gjirokastër, Zerqan,



REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIE

LLOJI I PASURISË SË PALUJTESHME QË SHPRONËSOHET: TOKE ARË, TRUALL, PYLLE, KULLOTË

Nr.	Numri i shtyllës	Të dhëna për pronësinë							Sip. Shpronësim në Lekë për shtyllë m2	Vlera e Shpronësimit në Lekë/m2	Vlera e Shpronësimit në Lekë për shtyllë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Sastë Sip pronës m2				
FSHATI RASHBULL												
					3215							
1	110	Tefik	Muharrem	Kallulli	3215	59/4	Are	2835	17.4	227	3949.8	
2	1	Tefik	Muharrem	Kallulli	3215	59/4	Are	2835	82.92	227	18822.8	
3	2A	Fatmir		Frahulli	3215	59/3	Are	300	51.84	227	11767.7	
4	2	Isuf	Kasem	Dervishi	3215	53/6	Are	3500	34.33	227	7792.9	
5	3	Pretendues			3215	53/7	Are	2500	96.04	227	21801.1	
6	4	Pretendues			3215		Arë		106.27	227	24123.3	
7	5	Pretendues			3215		Arë		34.33	227	7792.9	
8	6	Pretendues			3215		Arë		77.33	227	17553.9	
9	7	Pretendues			3215		Arë		74.02	227	16802.5	
10	8	Pretendues			3215		Arë		62.5	227	14187.5	
11	9	Pretendues			3215		Arë		34.33	227	7792.9	
FSHATI ARAPJ												
					1031							
12	11	Muharrem	Ibrahim	Pajaziti	1031	126/14	Are	1150	94.09	356	33496.0	
13	12	Pretendues			1031	192/7 192/8	Are	8700	77.33	356	27529.5	
14	14	Besim	Kadri	Tropolini	1031	242/10	Are	3760	42.82	356	15243.9	
15	15	Pretendues			1031		Are		34.33	356	12221.5	
16	16	Pretendues			1031		Are		41.46	356	14759.8	
FSHATI SHKALLNUR												
					3385							
17	17	Ramazan	Seit	Mucaj	3385	133/2	Are	2500	94.09	227	21358.4	
18	18	Egerem	Sabri	Muca	3385	133/5	Arë	7400	43.88	227	9960.8	
19	13 A	Mustafa	Jakup	Dervishi	3385	146/1-2	Arë	540	51.84	227	11767.7	
20	19	Bashkepronesi			3385	131/1	Arë	1350	58.32	227	13238.6	
21	20	Demir	Ramazan	Xhafa	3385	264/16	Arë	4900	40.56	227	9207.1	
22	21	Pretendues			3385		Arë		34.33	227	7792.9	
22	22	Bashkepronesi		Berberi	3385	433/5	Arë	2000	34.33	227	7792.9	
24	23	Pretendues			3385	490/4 491/1-10	Arë		34.33	227	7792.9	
25	24	Gezim	Copa		3385	535/8	Arë	2400	34.33	227	7792.9	
26	25	Robert	Myfolari	Puja	3385	565/20	Arë	7000	48.72	227	11059.4	
		Mynre				565/21	Arë	6000				
FSHATI KRYEMEDHENJ												
					2291							
27	26	Pretendues			2291	3/2 -	Arë		58.32	345	20121.7	
28	27	Xhemile	Ahmet	Sinarezi	2291	16/5/1	Arë	2300	34.33	345	11843.1	
29	28	Bashkepronesi		Dervishi	2291	26/2	Arë	2140	34.33	345	11843.1	
30	29	Azem	Islam	Dervishi	2291	70/6	Arë	1000	34.33	345	11843.1	
		Fatmir	Islam	Dervishi	2291	70/7	Arë	1100	34.33	345	11843.1	
31	30	Haxhi	Abdulla	Istrefi	2291	135/9	Arë	950	34.33	345	11843.1	
32	31	Hamid/ Shtet	Reshat	Shirja	2291	169/2 196/7	Arë	1000	34.33	345	11843.1	
33	32	Bashkepronesi		Shirja	2291	167/6	Arë	4600	77.33	345	26680.4	
34	33	Pretendues			2291	215/3	Arë		34.33	345	11843.1	
35	34	Petrit	Shefik	Tila	2291	215/7	Arë	10100	34.33	345	11843.1	
36	36	Pretendues			2291		Arë		58.32	345	20121.7	
37	37	Pretendues			2291	423/2 423/2	Arë		77.33	345	26680.4	
38	38	Pretendues			2291	425/8	Arë		47.33	345	16330.4	
FSHATI GOLEM												
					1791							
39	39	Pretendues			1791		Arë		112.36	345	38764.2	
40	40	Pretendues			1791		Arë		112.36	345	38764.2	
41	41	Pretendues			1791		Arë		40.56	345	13093.2	
42	31 A	Pretendues					Arë		73.96	345	25516.2	
43	42	Pretendues			1791		Arë		77.33	345	26678.9	
44	43	Pretendues			1791		Arë		34.33	345	11843.9	
FSHATI AGONAS												
					3961							
45	45	Lutfi	Masar	Zikullari	3961	8/1 -	Arë	10000	34.33	238	8170.5	
FSHATI AGONAS												
					3961							
46	47	Pretendues			3961	172/4	Arë		77.33	238	18404.5	
47	48	Besim	Beshir	Spanjollj	3961	35/4	Arë	5220	34.33	238	8170.5	
48	49	Xhevat	Zeqir	Copa	3961	70/4	Arë	12270	34.33	238	8170.5	
49	50	Idajet	Vath	Rruga	3961	71/3	Arë	2000	34.33	238	8170.5	
FSHATI KANAPARAJ												
					2071							
50	51	Pretendues		Spanjollj	2071	511/4	Arë		36.59	345	12623.6	
51	52	Pretendues			2071	512/25	Arë		54.61	345	18840.5	
52	53	Ibrahim	Shefqet	Kanapari	2071	512/20	Arë	12200	82.39	345	28424.6	
53	54	Ylli	Shefik	Kola	2071	750/14	Arë	3600	40.56	345	13993.2	
54	55	Selman	Shaqir	Spanjollj	2071	750/15	Arë	6400				
		Bashkepronesi		Çopa	2071	749/6	Arë	6000	132.25	345	45626.3	
BASHKIA KAVAJË												
KAVAJË												
					8551							
55	56	Pretendues			8551	2/					ska informacion	
56	57	Pretendues			8551	1/					ska informacion	
57	58	Pretendues			8551	1/					ska informacion	
58	59	Pretendues			8551	5/201					ska informacion	
FSHATI GOLEM												
					1791							
59	62	Pretendues			1791	87	Arë		112.36	345	38764.2	
60	63	Pretendues			1791	88	Arë		58.32	345	20120.4	
61	64	Pretendues			1791	56	Arë		77.33	345	26678.9	
SIPËRFAQE TOTALE PËR SHPRONËSIMI NË M²									3254.97			
SHUMA TOTALE NË LEK PËR SHPRONËSIM										967956.8		

SHBA
Ndërhyrja ruse, sipas zyrtarëve amerikanë, egërsoi në Siri një ambient që ishte tejet i rënduar. 85-90% e sulmeve kanë prekur opozitën e moderuar siriane, ndërsa të vrarët kanë qenë civilë



Avioni rus i rrëzuar në Sinai

RRËZIMI
Teoritë mbi rrëzimin e avionit në Sinai janë spekulime. Kështu ka deklaruar Kremli nëpërmejt zëdhënësit Peshkov, që tha se asnjë version s'është zyrtar sa kohë hetimet s'kanë përfunduar

homazhe me qirin dhe lule në nder të viktimave të aksidentit. Shënime, mesazhe të shkurtra, ngushëllime dhe mbi të gjitha pyetje rreth tragjedisë janë vendosur në memorialin e improvizuar ku shihen edhe foto të viktimave. Teksa e shohin të padrejtë atë që ndodhi, rusët kërkojnë përgjigje dhe hetime të plota mbi atë që ndodhi me avionin.

LUFTA
Kreu i forcave ajrore ruse, general-koloneli Viktor Bondarev, i tha së përditshmes "Komsomolskaya Pravda" se është bërë një analizim shumë i kujdesshëm i situatës në Siri e janë marrë në konsideratë të gjitha kërcënimet e mundshme. "Për këtë arsye vendosëm të nisnim në atë vend jo vetëm avionë luftarakë, bombardues apo helikopterë, por edhe bateri antiajrore", - sqaron ai. Një prej arsyeve që nxiti këtë vendim, - sipas Bondarevit, - është edhe rreziku se mjetet ruse mund të sulmohen apo rrëmben, si brenda Sirisë, ashtu nga territori i shteteve fqinje me të. "Për këtë arsye duhet të jemi të përgatitur, - argumenton ai, duke shtuar më tej se - Moskë ka aktualisht mbi 50 avionë dhe helikopterë në atë vend, saktësisht numri që i nevojitet për momentin".

Ndërkohë, duke folur përpara Komisionit të Çështjeve të Jashtme, në Dhomën e Përfaqësuesve të Kongresit amerikan, ndihmëssekretarja e Shtetit Anne Patterson akuzoi Moskën se po e "përkeqëson rrezikshëm luftën në Siri".

Pak ditë pasi hodhën poshtë deklaratat se ISIS rrëzoi avionin rus me pasagjerë në Sinai, shërbimet amerikane të inteligjencës tani sugjerojnë se grupi terrorist, ose struktura të tij, vendosën një bombë në avion. Avioni u rrëzua ditën e shtunë, pasi shpërtheu në ajër, duke vrarë 224 personat që ndodheshin në bord. Ai ishte nisur nga Sharm el Sheikh drejt Shën Peterburgut. Më herët, edhe qeveria britanike kishte sugjeruar të njëjtën pistë.

Të dhënat e fundit të shërbimeve sekrete amerikane sugjerojnë se shpërthimi ka gjasa të jetë shkakuar nga një bombë e vendosur në avion nga militantët e Shtetit Islamik. Sipas CNN, zyrtarët theksuan se megjithatë për momentin nuk është arritur asnjë përfundim zyrtar, pasi zyrtarët amerikanë nuk janë njohur me provat shkencore të mbledhura nga hetuesit.

Shërbimet sekrete sugjerojnë gjithashtu se dikush në aeroportin e Sharm el Sheikh mund të ketë ndihmuar për importin e mjetit shpërthyes në bordin e avionit. "Aeroporti ka mangësi në aspektin e sigurisë. Kjo dihet. Gjithashtu ka të dhëna që sugjerojnë për një ndihmë nga stafi i aeroportit", kanë thënë burimet.

Autoritetet egjiptiane, që po drejtojnë hetimin mbi incidentin, nuk kanë reaguuar publikisht ndaj deklaratave amerikane. Por që nga dita e ngjarjes ato kanë mohuar vazhdimisht përfshirjen e terroristit. Shenjat që sugjerojnë

përfshirjen e ISIS, ka thënë më tej një zyrtar amerikan, bazohen pjesërisht në monitorimin e mesazheve të brendshme të grupit terrorist. Këto mesazhe janë të tjera nga ato që ISIS bën në publik, ka thënë zyrtari.

RUSIA
Të gjitha teoritë në lidhje me shkakun e rrëzimit të avionit rus me 224 pasagjerë në bord në Sinai të Egjiptit

Moska: S'ishte atentat, por shton armët në Siri

Shërbimet amerikane të zbulimit: Ishte ISIS ose struktura të tij që vendosën bombë në avion



Trupat ushtarak Rus në Siri

janë spekulime. Kështu ka deklaruar Kremli nëpërmejt zëdhënësit Dmitri Peshkov, i cili tha se asnjë version nuk është zyrtar sa kohë hetimet nuk kanë përfunduar.

Dje u zhvillua funerali i parë. Nina Lushchenko, 60 vjeç, mësuese, u varros në Veliki Novgorod, në jug të Shën Petersburgut. Ndërkohë rusët në qytetin e dytë më të madh në vend vijonë të bëjnë

LAJME SHKURT



Protestuesit në Athinë, grushta deputetit të Demokracisë së Re


Një deputet grek u godit me grushta gjatë një proteste të zhvilluar pasditen e së enjtes në Athinë. Jorgos Kumucakos, deputet i Demokracisë së Re, u godit me grushta dhe sende të forta prej demonstruesve me origjinë nga krahina e Pondsës, territore ku banonin grekë që nga lashtësia, por që u zaptuan prej otomanëve gjatë genocidit turk në fillim të shekullit XX. Protesta u organizua në prej organizatave të grekëve të larguar nga këto zona, pas një deklarate të ministrit grek të Arsimit, Nikos Filis, se në atë periudhë nuk u krye genocid, por spastrim etnik. Kumucakos ndodhej mes turmës për të protestuar, kur u dhunua.

"Mafia Capital", Roma nis "nënën e të gjitha proceseve penale".


Ka nisur dje gjykimi i një prej organizatave më të mëdha të krimit në Itali. E ashtuquajtura "Mafia Capital", organizata dyshohet se ka vjedhur miliona euro të parave publike. Ky grup mafioz ka korruptuar funksionarë publikë, politikanë dhe biznesmenë me qëllimin për të fituar tendera me vlerë qindra miliona euro. Personazhi kryesor i këtij procesi është Massimo Carminati, një gangster neo-fashit, i cili do të merret në pyetje nga prokurorët përmes një lidhjeje në video-konferencë, pasi konsiderohet si një nga personat më të rrezikshëm. Kjo seancë cilësohet nga mediat italiane si "nënën e të gjitha proceseve penale".

Rumania me kryeministër të ri, vijojnë protestat në Bukuresht

Sorin Cimpanu është kryeministri i përkohshëm i Rumanisë. Presidenti Klaus Iohannis ka emëruar kryeministrin e ri deri në zgjidhjen përfundimtare të kreut të qeverisë, ndërsa mijëra vitë kanë vijuar protestat rrugëve të Bukureshtit, edhe gjatë kësaj të enjteje.



Ata kërkojnë drejtësi për vdekjen e 32 personave, të cilët humbën jetën në një klub nate. Qytetarët akuzojnë qeverinë për korruption dhe kërkojnë ndërmarrjen e reformave të gjera politike. Sipas tyre, klube të tilla janë hapur falë rryshfeteve. Pas zjarrit në diskutete, edhe kryebashkiaku i Bukureshtit, ku ndodhej lokalit, dha dorëheqjen.



Schulz viziton refugjatët në Greqi, fëmija afgan i kërkon para

Një refugjat i vogël është bërë personazhi i ditës në mediat greke dhe ato të huaja gjatë vizitës së kryeministrit grek, Aleksis Tsipras dhe kreut të PE-së, Martin Schulz, në ishullin e Lesbos. Në momentin e vizitës në një prej qendrave të pritjes, një fëmijë nga Afganistani i është afruar kreut të PE-së dhe i ka kërkuar para, duke i folur në anglisht. Në këtë kohë, kryeministri grek, duke qeshur i është kthyer refugjatit të vogël duke i thënë: "Mos i kërko para. Unë kam kaq kohë që i kërkoj". Pak orë para vizitës së dy lidhëse, 2 fëmijë kanë humbur jetën, ndërsa një varkë me 14 vetë është mbytur në brigjet e ishullit Kos.

Irani ndalon prodhimet amerikane të konsumit



Irani ka ndaluar hyrjen e të gjitha produkteve amerikane të konsumit në kuadër të perspektivës për një heqje të sanksioneve pas marrëveshjes për programin bërthamor. Lajmi është publikuar këtë të enjte në faqen on-line të Ministrisë irakene të Industrisë, Minierave dhe Tregtisë. "Për rirformimin e prodhimit irakene, është i nevojshëm ndalimi i hyrjes së prodhimeve amerikane të konsumit dhe i produkteve që simbolizojnë praninë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vend", thuhet në faqen e internetit të Ministrisë irakene, të drejtuar nga Mohammad Reza Nematzadeh.

Refugjatët, jo zona tranziti në kufirin gjerman

Kancelarja gjermane Angela Merkel dhe liderët e dy partive partnere të koalicionit të saj qeverisës, ranë dakord në mbledhjen e së enjtes, për të përshpejtuar procesin e regjistrimit të refugjatëve. Gjithashtu, liderët vendosën që azilantët do të qëndrojnë në shtetin e parë që ata janë regjistruar.

Ndërkohë, ata arritën marrëveshjen se nuk do të krijohen të ashtuquajturat "zona tranziti" në kufijtë e Gjermanisë. Ndërkëq, Komisioni Europian ka njoftuar se 3 milionë emigrantë pritet të hyjnë në kontinentin e vjetër deri në vitin 2017, ndërkohë që fluksi i tyre në ujërat e Detit Mesdhe vijon të jetë i lartë.



Repertori i përket albumit të fundit, publiku u ekzaltua

Alba Carmona: Ja pse zgjodhëm Tiranën për të sjell flamengon

Kuarteti "LAS MIGAS", i përbërë nga 4 artiste Alba, Marta, Alisia e Roser ndezën Katedralen

IZAURA NDOJ
TIRANE

Një spektakël i vërtetë i ndërthurjes së muzikës, këngës, kërcimit flamengo ndezi mbrëmë Katedralen Ortodokse

në Tiranë. Katër artistet spanjolle që kanë mrekulluar në çdo tur, këtë herë zgjodhën Tiranën për të sjell flamengon. "Las Migas" është kuarteti nga Spanja i përbërë nga 4 artiste Alba, Marta, Alisia dhe Roser, me origjinë nga veriu dhe jugu i Spanjës, të cilat i lidh së bashku pasioni i përbashkët: flamengo. Ambasada Spanjolle në bashkëpunim me shoqatën 'Syri Blu' mundësuan këtë koncert në Tiranë. Kuarteti 'Las Migas' përfaqësojnë një etapë të re, një lloj spektakli të ri, repertori të gjerë dhe vizion për të ecur përpara. Grupi përbëhet nga dy kitarë, një violinë dhe një këngëtare/balerinë, duke sjellë një kuartet të pazakontë femëror të flamengo-s dhe muzikës mesdhetare, një shpërthim tingujsh të pastër, unik dhe rebel. Ky është universi muzikor i Las Migas. Prej krijimit të tij viti 2004, kuarteti ka dhënë koncerte në teatro dhe festivallet më të rëndësishme të muzikës botërore.

Një koncert që magjepsi publikun shqiptar. Si lindi ideja për të sjell këtë performancë në Tiranë?

Idëja ka lindur fal Esterit, Zëvendës-ambasadorja e Spanjës e cila përpara se të ishte këtu ishte në Shkup. Atë e kemi njohur në Shkup, në kohën kur ajo punonte atje dhe ishte pikërisht ajo që na kontaktoi për të ardhur në Tiranë. Na duket një vend shumë i ndryshëm nga Spanja, ka shumë gjëra që na tërheqin vëmendjen ka dhe gjëra që janë të ngjashëm! Njerëzit janë shumë të dashur, shumicën në oraret e ditës i gjen në kafene, ka shumë diell, na tërheq se shumë njerëz që kemi takuar flasin spanjisht. Gjatë këtyre 48 orëve, kemi vënë re që shqiptarët kanë nevojë për të njohur kulturën

spanjolle. Kjo gjë na gëzon.

Kuarteti "Las Migas", çfarë të veçante solli më shumë nga flamengo tradicionale?

Ne themi gjithmonë se, baza është flamengo dhe duke marrë këtë bazë influenca muzikore që ka secila prej nesh ndërthurët në një të vetme.

Turë të ndryshme, kush janë elementët që ju garantojnë suksesin?

Së pari ne kemi një propozim muzikor që i bën njerëzit për vete, tërheqës! Në çdo koncert ka momente të ndryshme muzikore, ku gjen brenda, momente dramatike, të lumtura apo në ekzaltim. Nuk qendrojmë vetëm tek një performancë,

mundohemi të kemi larmishmëri në skenë.

Pse një kuartet me femra. Është element ky që ngjallë kuriozitet apo karakteristikat që ka secila përmbush suksesin në çdo vend ku performoni?

Kjo është një gjë e menduar, ka lindur natyrshëm. Është e vërtetë se kjo është një karakteristikë e grupit tonë dhe kjo bën që publiku të tërhiqet nga ky fakt. Mbi të gjitha, duke qenë se në flamengo nuk është tipike të ketë femra, kjo na ka rritur pritshmërinë e publikut, si një gjë e re në kuartet, por së brendshmi kjo nuk është diçka e menduar, Marta e ka iniciuar grupin, pasi ka luajtur në kitarë

dhe pastaj u formua kuarteti ku secila nga ne sjell pjesën e saj.

Cili është momenti më i veçantë kur jeni ngjitur në skenë në turet koncertore?

Kemi qenë në çdo vend, por ballkani ka qenë ai që na ka surprizuar më shumë. Ai që duhet veçuar është koncerti në Shkup, pasi kënga e parë që hapëm koncertin ishte një këngë maqedonase. Ai ka qenë një nga momentet më të mira që kemi pasur si grup. Publiku ishte i jashtëzakonshëm, këndoi bashkë me ne duke ndezur skenën.

Kush është çelësi i suksesit të flamengos?

Vetë flamengoja është një instrument muzikor i fuqishëm që njerëzit i bën për vete kudo që janë dhe mënyra që ne e sjellim në skenë është ajo që na ka garantuar suksesin.

Cili ishte repertori që ndezët sallën e Katedrales Ortodokse?

Repertori që sollëm i përket albumit tonë të fundit dhe përfshimë një pjesë të këngëve të reja që do regjistrujmë tani. Spektakli nuk ishte linear, pati momente të ndryshme, ku nuk përjashtuam as kërcimin apo të kënduarit solo. Ne përqipemi që dhe njerëzit të marrin pjesë, ne tentojmë që edhe pse tekstin nuk e kupton një pjesë e publikut ta ndiejmë këtë muzikë.



Sfida

Unë dhe Drini jemi në ndihmë të njëri-tjetrit për ta mbuluar në çdo vështirësi. Jemi si çift në garë, jo si individë të ndarë dhe kjo e bën më të bukur sfidën tonë në skenë



Viola Spiro:

Ndihem e plotësuar, kam gjetur mashkullin e zemrës

Një rrëfim nga ish-velina e 'Fiksit', "Dance With Me", spektakli i duhur. Pas ndarjes me Arjonin u përfol në lidhje me Bekim Balajn



Izaura Ndoj
TIRANE

Prezantuesja e njohur Viola Spiro ose siç e njohin të gjithë ish-Velina e "Fiksit", po sfidon veten në një tjetër show, atë të kërcimit. Edhe pse prej javësh, herë në vjen joshëse, herë dramatike, sensuale apo në rol befasues, Viola në këtë rrëfim na tregon të gjithë pasionet e saj, raportin fantastik që ka me Drini Zeqon, por edhe atë që e bën të jetë në qiellin e shtatë, dashurinë! Bukuroshja e cila prej kohësh është përfshirë në lajmet rozë për shkak të afrimitetit me Bekim Balaj, futbollistin e kombëtares, Viola parvarësisht se e ka mohuar, këtë herë thotë se është e dashuruar. Kujtojmë se show girl-i shqiptar ka pasur një lidhje disa vjeçare me Arjon Muçën, i cili u bë i famshëm pas pjesëmarrjes në "Big Brother".

Baleti hyn tek pjesa e artistit kreativ, çka e bën atë mjaft të vështirë, por njëkohësisht ka edhe argëtimin brenda. Çfarë ju nxit drejt rrugës së baletit?

Unë jam pjesë e një spektakli që ka si qëllim kërcimin dhe argëtimin. Kjo më ka nxitur më shumë të marr pjesë, pasi gjithmonë kam qenë e shkathtë në kërcim, por jo aq sa ta merrja seriozisht si profesion.

"Dance With Me", është një tjetër format që ju keni spikatur në garën e artistëve... Si është raporti tuaj mes kolegëve?

Është ndër më të mirët, që kam hasur ndonjëherë në grupe me shumë njerëz.

Çfarë e bën kaq të vështirë baletin?
Disiplina dhe teknika e mësuar për vite si dhe aftësitë e lindura. Duhet talent i lindur

dhe shumë punë.

Ju dhe Drini, një dyshe energjike që i jepni pozitivitet skenës. Sfidoni njëri-tjetrin apo secili jep maksimumin?

Jemi në ndihmë të njëri-tjetrit për ta mbuluar në çdo vështirësi. Jemi si çift në garë, jo si individë të ndarë dhe kjo e bën më të bukur sfidën tonë në skenë.

Keni qenë një prej balerinave kryesore dhe ndër vajzat më të bukura të emisionit "Fiks Fare". Pse u larguat prej aty?

Po, ndër ato që kanë rezistuar 4 vjet. Koha më e gjatë ndonjëherë, prandaj nuk mund të vazhdonim më shumë.

Mesa kemi kuptuar, përveç baletit jeni e apasionuar edhe pas modelingut. Pse kjo zgjedhje?

Kur kam qenë e vogël, isha modele për veshje femijësh në Greqi. Kjo ka vazhduar edhe në Shqipëri me aq sa të ofronte tregu. Jam më shumë e apasionuar pas sporteve sesa modelingut.

A mendoni se në Shqipëri modelet vazhdojnë të paragjyken?

Jo, ka ndryshuar çdo gjë. Vlerësohen më shumë se më parë.

Si një vajzë edhe e botës së modës, me një trup perfekt, i jeni nënshtruar ndonjë operacioni plastik?

Ushqehem mirë dhe merrem me fitnes. Më kanë falur prindërit metamobilizëm të mirë dhe tipare që i rezistojnë kohës. Më vonë se di...

Pas lidhjes me Arjonin, vazhdoni të jeni e dashuruar?
Po.

Kush është mashkulli që ka zënë vend në zemrën tuaj në këto çaste?

Me i miri...

Që do të thotë se Princi i Kaltër ju ka plotësuar shpirtërisht. Cilat janë ato gjeje që ju bën për vete?

Adhurimi ndaj meje.

Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- VIDEO/Dyndje masive në dyqanet H&M, njerëzit në rradhë prej ditësh
- Ndocaj "merr udhën" për Kuvend përsërit në makinë fjalimin d'Onjitoz
- Sherr mes dy shoqëruesve të Bujar Nishanit, i largojnë nga eskorta e tij
- Shkon për vizitë të mjeku, i thonë se ka dhe... vetëm 30 minuta jetë
- Ndahet Floriana Garo nga Tedi Ngjela pas 5 viteve bashkë
- Taksë e re për trojet, ja sa do të paguhet për qytetet dhe banesat
- Miqësia në Facebook që u kthye në makth, pranga mashtruesit shqiptar
- Foto/Dy aeroplanët më të mëdhenj në botë në hapësirën ajrore shqiptare
- Berisha: Miqtë e mi hakera zbuluan se Rama do marrë dhe 3 Benz blind
- Rinas, ekstradohet në Itali, bosi i grupit të kokainës, Edmond Tepshi

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Ndocaj "merr udhën" për Kuvend përsërit në makinë fjalimin d'Onjitoz
- I tha "kafshë", Beqaj: Zonja Dedaj ndjesë, njeri i gjallë jam
- Berisha: Miqtë e mi hakera zbuluan se Rama do marrë dhe 3 Benz blind
- Prej 8 muajsh pa drita, banorët e Institutit protestojnë para Kuvendit
- Zjarr në laboratorin kriminalistik Basha: Po dëgjin provat e drogës

VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE

Video e grabitjes së kazinosë: Hidhi të gjitha se të vras! 'Janë letra vlla'

Ja si tallen studentët në UET në "tempullin" e arsimit privat


"Pristje hesapsh" mes grupit orataku plagos dy kushërinjtë

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZH I DITES

A jeni dakord që Kosova të përdorë si monedhë të saj lekun?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:


Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kamponëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



1,570 | 226,058
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

INA KOSTURI
TIRANE

Nga një studio televizive teksta promovohet libri "Kandidati" i Ben Blushit më ngjau se u pushkatua për herë të dytë Lef Nosi. Pas kaq vitesh, në Shqipërinë moderne ndodhi ajo që nuk realizoi as Enver Hoxha, tallja, denigrimi, e deri tek thirrja për të tërhequr zvarrë monumentin e një njeriu të pushkatuar, pa varr... U trishtova se këtë herë ishin çuna bordurash as 50 vjeç që i shqetësonte kaq shumë një përmendore, një vepër arti e realizuar mjeshtrërisht, që në fakt e quanin bust! Shqipëria e sotme u përsi në një debat mediatic në shkrime, statute, blogje, njerëzit rëmbyen penën moderne të rrjetëve sociale, e si shkrimtarë treguar respekt dhe hera herës padituri, mosnjohje të historisë. Nga një studio më e vogël dikush tjetër, akoma më i ri komentonte se Lef Nosi vultose pulla! Të tjerë personalitete, historianë reagueshan ndaj këtij debati, mirëpo akoma dhe sot për një lexues të gjerë nuk u saktësuan shumë fakte. Flas për njeriun e zakonshëm që dëshiron të blejë një libër ku gjen figura historike dhe njerëz realë të ndërthurur enkas për ta ngatërruar, për atë që përtej mbeturinës së dikurshme të luftës së klasave, përtej lëndimeve, ngacimit, pasionit, kërkon të vërtetën. Duhet përmendur ato 52 kumtesa të mbajtura nga historianë, studiues, në Konferencën shkencore në Elbasan në nderim të Lef Nosit, atje ku rendën të gjithë duke filluar diskutimin nga kodikët e vjetër e deri tek historia e hebrejve... Personalisht nuk më intereson inati që ka Ben Blushi me Lef Nosit, ndonëse më bën qnd, madje më skandalizon, nuk më interesojnë as ato që media përdor kundër Blushit. Kjo histori nuk është një histori gjyshërisht si dikush përpiqet ta ngjyrosë, as familjesh, as brezash. Lef Nosi nuk ishte gjysh, një nga mbesat që i qëndroi pranë në momentet e vështira është ndarë nga jeta që në vitin 2008. Në një moment kur në media janë botuar vazhdimisht shkrime, fakte, dokumente për Lef Nosit, dalja e Blushit ngjan paksa teatral. Kjo është vetëm historia e tij, inati i tij, fantazia e tij për Lef Nosit real dhe pasardhësit që janë të shumtë dhe me emra në botën intelektuale shqiptare, e që gjoja fantazisht i denigron deri në shpirt të dokumentit të Pavarësisë! Kjo ndërthurje e personazheve reale dhe fantazi e çorienton lexuesin e thjeshtë. Nuk e kam lexuar librin dhe nuk dua ta lexoj për të ruajtur qetësinë... ndoshta për mos shtuar inatin a frenuar dëshirën për të shkruar një tjetër libër... Më skandalizon brutaliteti për të vendosur gjithçka vetë nga një studio, për ta shkruar historinë sipas dëshirës. Më tremb nocioni i historisë pronë e politikës, e deputetëve. Nëse kjo është një sindromë e luftës së klasave e shfaqur sot, sigurisht ka vetëm një palë dhe ky është vetëm Blushi. Pak javë më parë u ndërua Dhimitër Shuteriqi, dhe si në shumë aktivitetet të Akademisë së Shkencave mund të isha atje, pa ditur këtë inat të madh... Ajo që vërtet përben inat në tërë këtë zhurmë të stisur, tallje pa sens, është figura e Lef Nosit. Kaq shumë urrejtje nuk kam parë tek asnjë artist burgosur e vuajtur nga diktatura... Sigurisht, askujt, as Blushit e askujt nuk do t'i vinte mirë që t'ja përmendnin njerëzit nëpër libra, t'ja bënin personazh e aq më tepër ta ngatërronin fantazinë me realitetin... Pak vetë do mermin guximin për të tillë letërsi. Pa dashur të ndalem në atë që një pjesë e njohin e pak të tjerë nga njerëzit e zakonshëm e kanë lexuar këto ditë, veprimtaria e Lef Nosit gjendet në fondin prej mijëra faqesh në Arkivin e Shtetit. Për njerëzit e thjeshtë që fatqesisht duan pak histori të shpejtë, ata që historinë ua rrenjosi komunisti, kontributi i Lef Nosit u pëlqen ose jo është i qmuar. Teksa përmendim vitin 1909 kur themelon dhe drejton shoqërinë "Aferdita", apo 1910 kur boton të parën gazetë të qytetit të tij të Elbasanit, "Tomorri" ndihmesën e madhe në punimet e Kongresit të Elbasanit, si dhe hapjen në shkollë Normale, kuptojmë se shpejt u bë personalitet i shquar në gazetë, ku botoi shkrime, artikuj të përkthyer nga shtypi evropian duke pasqyruar problemet dhe interesat kombëtare shqiptare. Dy artikuj të përkthyer nga shtypi evropian asokohe u bënë shkak që turqit e rinj



Blushi e pushkatoi për herë të dytë Lef Nosit

Faktet tregojnë se "fashisti" është pjesë e fantazisë dhe mosnjohjes së historisë. Ja letra që Qemal Stafa, më 15 mars 1941, student në Firence i drejton Lef Nosit që ishte i internuar në Itali

ta arrestonin dhe t'i jepnin dënimin kapital. U dëshën ndërhyrjet e patriotëve dhe opinionin ndërkombëtar që dënimi të kthehej me internim në Bursë të Turqisë. Firmosja më 28 nëntor 1912 e Aktit e Pavarësisë dhe emërimi si ministër i Postë Telegrafëve e bën më të rëndësishëm. Pjesëtar në delegacionet e Qeverisë së Vlorës në Konferencën e Paqes për kufijtë e Shqipërisë, si dhe në delegacionet e pritjes së Princ Vidit duket se është prezent në ngjarjet më të rëndësishme shqiptare, falë zotësisë, personalitetit, zotërimit të shumë gjuhëve dhe falë përkushtimit si shumë personalitete të tjera për fatet e Atdheut. Mirëpo sot të bërit humor me personalitetet duket se është në mod! E nëse sot përpigëmi të imitojmë Komicën për të nxjerrë inatin me Lef Nosit, siç lexova rëndom, tregojmë se nuk kemi lexuar shumë, madje fare. Letërkëmbimi i Konicës me Lef Nosit dëshmon për fuqinë e personalitetin e këtij të fundit për zgjidhjen e një sërë problemesh që Konicia i shikonte të rëndësishme në Shqipëri dhe Lef Nosit e konsideronte si njeriun e aftë e të mençur për t'i zgjidhur. Nëse vazhdojmë rrugëtimin në histori viti 1919 shënon pjesëmarrjen e Lef Nosit në Kongresin e Durrësit, si dhe përshëndetjen nga jashtë vendit me telegram të Kongresin e Lushnjës. Si mik i Fan Nolit, fanolist, antizogist u tërhoq nga jeta politike dhe

iu kushtua studimeve gjuhësore, historike, etnografike, albanologjike, fushave të filatilisë, numizmatikës e mbledhjes së shprehjeve e fjalëve të urta, dokumenteve e librave të rrallë me vlerë për historinë tonë. Sado të përpigëmi të flasin si fëmijë, si nxënësit e prapë të shkollave në fillimet e demokracisë shqiptare që zhgarravin portretet e rilindasve, të bëjmë modernin, të duam të heshtim, kontributet e Lef Nosit nuk mundemi sërish t'i mohojmë. I internuar në Itali si antifashist për organizimin e demonstratave të rinisë dhe popullit të Elbasanit që kërkonte armë për të pritur me luftë pushtuesit fashistë italianë duket se përsërit qëndrimin e mbajtur dhe më parë, në vitin 1914, kur bashkë me 300 burra nga Shqipëria e Mesme shkoi të mbrojtë Korçën nga grekët. Faktet tregojnë se "fashisti" Lef Nosi, i cilësuar kështu rëndom këto ditë, pa dashur të përmend një numër të madh shkrimesh që e nderojnë si figurë të rrallë, është pjesë e fantazisë dhe mosnjohjes së historisë. Krahas letërkëmbimeve, disa akoma të panjohura me personalitetet si Fan Noli, Konicia, Luigj Gurakuqi e shumë të tjerë mbetet interesant letërkëmbimi me të riun komunist Qemal Stafa. E nëse do flisja apo imitoja atë që media na servir do duhej të shkruaja; Hej, njerëz, paska patur letërkëmbim me vetë Qemal Stafën, simbolin e të riut komunist dhe

vetëm disa muaj para themelimit të Partisë Komuniste! Nga ky letërkëmbim ruhet gjer më sot vetëm një letër që Qemal Stafa, më 15 mars 1941, student në Firence i drejton Lef Nosit që ishte i internuar në Itali.

Lef Nosi paska qenë dhe i internuar në Itali! Pra, disa muaj para themelimit të Partisë Komuniste... Letra fillon "I nderuari Lef Nosi. Së pari dëshiroj t'ju tregoj gëzimin shpirtëror që më ka shkaktuar njoftja e juaj, gëzim që jam i sigurt nuk do ta konsideroni si shfaqjen e një konvencione të zakonës, por si një realitet..... Letra përfundon..... Përherë në dispozicion të juaj për sa të ju nevojitet. Ju lutem të pranoni shprehjen e nderimi ma të thellë.


Qemal Stafa Via Nicolini 5 Casellari.

Nëse do vazhdonim rrugëtimin në momentet kryesore të historisë së Lef Nosit janë 11 muaj që do duheshin të zbardheshin dhe të lexoheshin drejt. Periudha e mëvonshme shënon dy momente, së pari nënshkrimin e Pavarësisë nga Italia, duke e bërë kështu dy herë nënshkruar të Pavarësisë së Shqipërisë. Çdo përpigëmi për ta krahasuar me të tjera personalitete shqiptare është e stisur duke ngatërruar faktet, e qëllimshme për t'i ulur meritat. Duhet kujtuar se një Asamble Kushtetuese më parë i kishte dhuruar kurorën e Shqipërisë Imperatorit Viktor Emanuel III, pra nuk ekzistonte Shqipëria e pavarur e 1912. Nga territori shqiptar në vitin 1940 ushtritë italiane sulmuan Greqinë. Me kapitullimin e Italisë Fashiste në shtator 1943 boshllëku që krijoi largimi i trupave italiane e zunë gjermanët të cilët i trembeshin zbarkimit aleat në Ballkan. Për të treguar që gjermanët hynin në Shqipëri dhe jo në Itali u mblood Kuvendit Kombëtar, i cili në 22 tetor 1943 miratoi dhe dekretoi 5 vendime duke bërë të mundur shfuqizimin e Asamblesë së 12 prill 1939, e cila kishte votuar për bashkimin personal midis Shqipërisë dhe Italisë dhe rrjedhimisht shfuqizimin e gjithë ligjeve, duke shpallur asnjësinë nga konflikti botëror. Pra një shtet i pavarur dhe asnjësinë.

Në këtë periudhë Lef Nosi zgjidhet si përfaqësuesi ortodoks në Këshillin e Naltë të Regjencës së bashku me Mehdi Frashërin, Fuat Dibrën dhe Patër Anton Harapin... Pra në këto vendime dhe në procesverbale të Kuvendit Kombëtar 1943-44 ribotuar nga Kuvendi me rastin e Pavarësisë nuk gjendet asnjë rresht dhe asnjë firmë e Lef Nosit kundra Shqipërisë. Për të faktuar asnjësinë dhe pavarësinë e Shqipërisë në këtë kohë, që është ngjashme me gjestin e Themistokli Gjermanit me Republikën e Korçës, midis shumë faktorëve mund të theksojmë se pavarësisht nga urdhrat e prera dhe masakrat ç'njerëzore të bëre me porosi personale të Hitlerit, për zgjidhjen përfundimtare të problemit Hebre, sipas dokumenteve të publikuara së fundmi nga historianët tanë "Qeveria shqiptare e quan qeshitjen hebreje qeshitje të brendshme të saj, pra në Shqipëri nuk mund të veprohet..." Kjo përbën bazën e qëndrimit të popullit shqiptar mbi hebrejtë vendas dhe ata që u strehuan gjatë Holokaustit. Nuk është për t'u çuditur që gjyqi komunist dënoi për fshehtë të Lef Nosit dhe një të ri hebre si inxhinier Marko Menahemi që ish arratisur nga kampet e përqendrimit. Makina ushtarake gjermane nuk mundi të vinte në përdorim në Shqipëri markën e okupacionit dhe u detyrua çdo gjë ta blinte në Shqipëri me valutë. Shteti shqiptar i dha shtetit gjerman 20 milion franka kredit të cilat u kthyen pas luftës. Marrëdhëniet midis shtetit shqiptar dhe gjerman bëheshin midis ministrave të Jashtme dhe konsullatave. Një situatë e tillë zgjati deri në 26 tetor 1944 kur qeveria shqiptare dhe Regjencia dhanë dorëheqjen. E gjithë kjo mjeçullinë mbi "kolaboracionizmin" sqarohet duke hulumtuar në arkivat në dokumentet... Arsyet pse Lef Nosi e të tjerë ndërmorën këtë hap e shpjegon Patër Anton Harapi në fjalimin e tij, si dhe rrëfimi i Hafëz Musa Basha, teksta tregon përgjigjen e Lef Nosit me një frazë: "Kusnat janë të rinj, serbi jua ka me hile". Kjo frazë shpjegon dhe zgjidhjen në momentin e vështirë. Nëse sot duhet ndëruar Lef Nosi, mjafton emri i Shqipërisë i përmendur në çastet para pushkatimit. Shqiptarët kanë nevojë ta njohin historinë nëpërmjet faktëve, me urrejtje, paqe, në të kundërt e shkuara, diktatura është gati të trajtojë pa mëshirë ditët tona deri sot.

Lilaj: I lumtur për 2 golat dhe pikët e para në Europë

Sabien Lilaj ishte autori i dy golave për Skënderbeun përballë portugezëve. Pas ndeshjes mesfushori i u shpreh i kënaqur me pikët e para, por edhe në aspektin personal. "Ishte një ndeshje e fortë, pavarësisht rezultatat. Jam i kënaqur që fituam përballë një kundërshtari si Sportingu, që na dhanë 3 pikët e para në Europa League. Por edhe personalisht për dy golat" tha ai.



Skënderbeu fiton 360 mijë € 30 mln Lekë për lojtarët

Fitorja ndaj Sportingut nuk ka vetëm vlerën historike të 3 pikëve në Europë, pasi korçarët fitojnë 360 mijë Euro nga UEFA, nga të cilat 30 mln Lekë presidenti Takaj i kishte vendosur për 'kokën' e Sportingut. Ndërsa ndryshe nga ndeshjet e tjera që ka zhvilluar këtë edicion në Europë përballë Sportingut në Elbasan kishin udhëtuar një numër i vogël tifozësh.



Historike, Skënderbeu turpëron Sportingun e Lisbonës në Elbasan

3 gola nga shqiptarët për 3 pikë dhe 360 mijë Euro

DYLBER BALLA
TIRANË

Skënderbeu siguron fitoren e parë në fazën e grupeve në Europa League, pasi mposhti në mënyrë të habitshme Sportingun e Lisbonës në Arenën e Elbasanit 3-0, pavarësisht se nuk ishte me formacionin e parë. Me mungesat e Salihit në fushë dhe tifozëve në shkallët e stadiumit Skënderbeu bëri një nisje përballë portugezëve të Sportingut të Lisbonës, që edhe tifozi më i zjarrtë nuk do ta kishte besuar, pavarësisht se dëshira për të marrë pikët e para ishte e madhe, pasi edhe shpërblymimi 30 milionë Lekë të reja ishte një arsye më shumë. Duke përfitur nga rreshtimi i gabuar i portugezëve si pasojë e neglizhencës, Skënderbeu shënon golin e parë në minutën e 15 me Sabien Lilajn. Meritë në golin e parë kishte Berisha që zbriti me shpejtësi nga e majta duke u futur në zonë dhe pasuar saktë për Olainkën, që gjuan në vështirësi, por portieri Patricio grushton duke kthyer topin gabimisht te kundërshtarët, aty përfiton Lilaj që nuk fal duke e ndalur serën në rrjetë. Goli 'orienton'



Deklaratat

Josa i kënaqur me fitoren Jesus i zhgënjyer nga loja

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe, fitorja dhe paraqitja e ekipit në fushë ka marrë vlerësimet maksimale edhe nga trajneri Mirrel Josa. "Ndryshe nga ndeshja e parë në Portugalin e nisëm më mirë duke shënuar që në fillim. Dalja me karton të kuq na ndihmoi, pasi shënuam shumë shpejt edhe golin e dytë duke e vendosur ndeshjen përpara. Në pjesën e dytë shfrytëzuam gabimet e kundërshtarit duke volorur gjithçka" deklaroi ai. Ndërsa trajneri i Sportingut, Jesus u shpreh se duhet të shikojmë përpara për ndeshjet e tjera dhe të harrojmë paraqitjen në Shqipëri. Pas 4 ndeshjeve të para në grupin H, kryeson Lokomotiva e Moskës me 8 pikë, pasi barazoi në ndeshjen e mbërshme nuk shkoj më shumë se një barazim 1-1 me turqit e Beshiktashit, që renditet në vendin e dytë me 6 pikë 2 më pak se rusët. Ndërsa Sportingu ndodhet në vendin e tretë me 4 pikë, një më shumë se Skënderbeu që e mundi. Sportingu duhet që të fitojë dy ndeshjet e fundit përballë Lokomotivës dhe Beshiktashit për të siguruar kalimin e grupit.

miqtë, ndërsa kampionët e Shqipërisë përfitojnë nga momenti i mirë duke u hedhur në sulm në kërkim të golit të dytë që e gjejnë në të 19'. E ndërsa goli i parë erdhi nga e majta, i dyti ishte meritë e Latifi nga e

djathta, pasi mori maksimumin nga një pasim nga mesfusha duke u futur në zonë dhe i vetëm me portierin mik, pengohet në mënyrë të gabuar. Arbitri estonez vendos të japë penallti për Skënderbeun, ndërsa lar-



gon me karton të kuq Patricion. Penalltinë e merit për sipër për ta ekzekutuar Lilaj, që nuk gabon duke e dërguar për herë të dytë në rrjetë. Dy gola në 4' as në ëndrrën më të bukur, Lilaj dhe Skënderbeu nuk i kishin parë. Në pjesën e dytë pritej një reagim nga Sportingu, por sërish befason Skënderbeu këtë herë pas një gabimi të portugezëve. Në minutën e 56 pas një gabimi të miqve me portierin Marcelo Boeck, i cili pason në mënyrë të gabuar duke i dhënë mundësinë Nimgagës të rikuperojë topin dhe të lëshojë një parabolë nga mbi 20 metra duke zënë në befasi gardianin, pasi kishte dalë nga


GRUPI H

- Skënderbeu 3-0 Sporting
 - Beshiktash 1-1 Lokomotiva
- RENDITJA**
- Lokomotiva 8
 - Beshiktash 6
 - Sporting 4
 - Skënderbeu 3

porta. Topi ndalet për herë të tretë në rrjetë dhe Skënderbeu nuk u beson syze, 3 gola në 56' përballë Sportingut.

SULMUESI

Benzema rrezikon 5 vite burg për shantazh, Dëshamp nuk e grumbullon



Benzema është zyrtarisht në telashe, pasi është marrë i pandehur në çështjen e shantazhit me një video erotike ndaj Valbuena. Prokuroria e akuzon për shantazh duke rrezikuar 5 vite burg. Sulmuesi francez gjatë marrjes në pyetje ka pranuar shantazhin ndaj Valbuenës. Mediat franceze kanë zbuluar shantazhin e Benzema ndaj Valbuenës "Mos u shqetëso, nuk ka zgjidhje. Do ia ndryshoj mendjen dhe Valbuena do pagujë". 3 persona i kërkoni 150 mijë euro Valbuenas për të mos e publikuar videon erotike, ndërsa Benzema që bënte lojën e dyfishtë e këshilloi shokun e tij të skuadrës për të paguar shifrën e kërkuar. Pas zhvillimeve të fundit e ndërsa Reali e ka pjesë të listës për La Ligan, trajneri Dëshamp nuk i ka grumbulluar në kombëtare për miqësoret me Gjermaninë dhe Angli duke u shprehur "Benzema është i dëmtuar, ndërsa Valbuena nuk është mirë psikologjikisht".

RENDITJA NË FIFA/ KUQEZINJTË TË 36 NË BOTË PËR NËNTORIN

Shqipëria zbrit 4 vende pas humbjes me Serbinë

Zbritja në renditje ka ardhur pas humbjes me Serbinë në Elbasan më 8 Tetor

Shqipëria ka humbur 4 pozicione në renditjen për muajin nëntor në FIFA. Zbritja në renditje ka ardhur pas humbjes me Serbinë në Elbasan më 8 Tetor më rezultatin 0-2, ndërsa fitorja në Armeni më 11 Tetor që solli edhe kualifikimin nuk ka mundur që të ndalojë humbjen e 4 pozicioneve duke bërë që kuqezinjtë të renditen në vendin e 36. Shqipëria numëron 723 pikë në renditjen e muajit nëntor, 32 pikë më pak se një muaj më parë. Ndërsa nga renditja historike



në vendin e 22 në FIFA në muajin gusht kombëtarja shqiptare ka humbur 14 pozicione por kjo pak rëndësi ka sepse nëse disa muaj më parë kuqezinjtë nuk e kishin siguruar ende kualifikimin në Euro 2016, tashmë janë zyrtarisht pjesë e Europianit Francës. Shqipëria ka ende shanse që ta mbyllë vitin 2015 me një renditje të mirë, pasi në nëntor ka edhe dy ndeshje miqësore për të zhvilluar edhe pse njëra prej tyre nuk është zyrtare. Në renditjen e ardhshme për kombëtaret në FIFA

do të llogaritet vetëm ndeshja me Gjeorgjinë, pasi Kosova ende nuk është njohur zyrtarisht nga UEFA dhe FIFA. Ndërsa me Gjeorgjinë kuqezinjtë do të tentojnë fitoren për të mbyllur në mënyrën më të mirë epokën e stadiumit 'Qemal Stafa' pasi në Janar të vitit 2016 do të shembet, pasi do të ndërtohet 'Arena Kombëtare'. Për t'u rikthyer te renditja e FIFA-s për nëntorin surprizë për muajin nëntor është ngjitja e Belgjikës në vendin e parë, Gjermania, kampione bote e dyta.